



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 20 SHTATOR 2021**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 20. SEPTEMBRA 2021. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR
2021**

Rendi i ditës

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit,
6. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 8 (tetë) anëtarë nga komuniteti shqiptar dhe 1 (një) anëtar nga komuniteti serb në Bordin e RTK-së.

Dnevni red

1. Izjave van dnevnog reda,
2. Parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednica,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-013 o vlasničkim pravima stranih građana u Republici Kosovo,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-017 o Agenciji za sprečavanje korupcije,
6. Formiranje Komisije ad hoc za izbor osam (8) kandidata iz redova albanske i jedan (1) kandidat iz redova srpske zajednice u Upravnom odboru RTK-a.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë me punimet e kësaj seance, në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe tuajin si deputetë të këtij Kuvendi, shprehim ngushëllimet tona për familjarët që i humbën më të dashurit e tyre gjatë kësaj kohe nga pandemia COVID-19. U prehshin të qetë!

Të nderuar deputetë,

E nderuar zëvendëskryeministre,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Po i hapim punimet e seancës plenare të Sesionit vjeshtor të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen të cilën e mbajtëm më 13 shtator 2021.

Me këtë rast ju kisha lutur në mënyrë të veçantë që ta keni kujdesin e shtuar për t'i zbatuar masat që i ka rekomanduar Instituti i Shëndetit Publik për t'u mbrojtur nga pandemia COVID-19. Pra, kërkohet në veçanti përdorimi i maskave, si dhe mbajtja e distancës së nevojshme nga secili prej jush.

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës

Prej Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje është paraqitur kryetarja e grupit, Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Zëvendëskryeministre,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, ju në Kosovë dhe në diasporë,

Mirë se u kthyem bashkë në Sesionin vjeshtor të Kuvendit të Republikës!

Fillimisht, më lejoni që gjithashtu në emrin tim personal dhe të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje t'u shprehim ngushëllimet më të sinqerta të gjithë familjeve që humbën të dashurit e tyre nga infektimi me virus SARS COV-2, që nga dita kur ne përmbyllëm punimet e sesionit pranveror. Ishte një periudhë e rënduar me numra të lartë si rrjedhojë e prezencës së virusit të modifikuar DELTA dhe gjithë gëzimi e angazhimi i familjeve në ahengjet familjare, fatkeqësisht për një numër të konsiderueshëm të qytetarëve tanë doli të jetë me pasoja për jetën e tyre.

Pas një periudhe njëmuajore nga 12 gushti, kur e mbajtëm seancën e fundit të sesionit pranveror, në deklaratime jashtë rendit të ditës apeluam për vaksinim të të gjitha grupeve të qytetarëve, të

cilët plotësojnë kriterin e moshës për vaksinim, numri i të infektuara me variantin e ri DELTA është rritur dramatikisht. Një fakt për t'u përmendur është se shumica e viktimave, apo mbi 90% nuk ishin të vaksinuar.

Sot kur kemi arritur të kemi mbi 1 milion qytetarë të vaksinuar dhe mbi 35% të qytetarëve të moshës madhore të vaksinuar me dy dozat, duhet ta kemi të qartë se normalizimi nuk mund të arrihet nëse nuk e kalojmë 60% të vaksinuar me të dy dozat e vaksinës. Andaj, e domosdoshme dhe e paalternativë për tejkalimin e krizës mbetet vaksinimi dhe vetëm vaksinimi.

Të dashur qytetarë,

Të gjithë do të mund të bënim më shumë dhe më mirë për të parandaluar atë me çfarë u ballafaquam javët dhe muajt e shkuar. Më e madhe sfida, më i madh duhet të jetë mobilizimi ynë për të tejkaluar vështirësitë, me të cilat po ballafaqohemi. Përveç sfidës së madhe të pandemisë, e cila zgjedhjen kryesore e ka vaksinimin, janë sfidat e tjera të mirëqenies që plotësohen me vendimet dhe mekanizmat për shtet të barabartë dhe social.

Krijimi i mekanizmave të shtetit me mirëqenie sociale, të filluara nga Qeveria Kurti, po e forcon bazën për një shoqëri të shëndoshë dhe një të ardhme të mirë për gjeneratat e reja. Vendimi i Qeverisë për shtesat për nënat lehona të papuna, në vlerë prej 170 euro për gjashtë muaj, dhe ato të punësuar, në vlerë të njëjtë për 3 muaj, është vendimi i cili jo vetëm që ndihmon familjet e reja, por edhe siguron që parametrat demografikë të mos kalojnë në negative, sipas trendit aktual që e kishim. Për dikë që mund të ketë dyshuar në këtë masë, interesimi i nënave dhe familjeve për shtesat është i madh. Vetëm në javën e parë, pas njoftimit dhe fillimit të aplikimit prej të hënës deri të premten, aplikimet janë 13 180, prej tyre 1 505 mbështetje për gra lehona dhe 11 679 shtesa për fëmijë.

Qeveria e Republikës së Kosovës sapo u bëri thirrja vajzave dhe grave profesioniste për aplikimet në bordet udhëheqëse të ndërmarrjeve publike, ndërsa ato vajza dhe gra që studiojnë dhe mendojnë për punësim, nuk janë vetëm. Shumë shpejt do të publikohen masat për vajzat dhe gratë për punësim dhe ndihmë në vetëpunësim.

Një kategori, për të cilën duhet pasur vëmendje të veçantë në këta muajt e fundit janë bujqit dhe fermerët, që u pa se ishin dëmtuar nga abuzimi sistematik që u bë me grante ndër vite në Ministrinë e Bujqësisë, porse tani duhet gjetur të gjitha format e duhura që përveçse të vendoset rregull dhe verifikim për përfituesit e granteve, gjithashtu të rriten subvencionet për bujqësi.

Masat e reja për një shoqëri me mirëqenie për të gjitha kategoritë do të vazhdojnë, por nuk duhet të harrojmë se për t'u kthyer në një normalitet të plotë të gjithë duhet të vazhdojnë të vaksinohen. Siç ishte e paraparë, që nga 15 qershori kur ishim në një situatë më të qetë pandemike, zgjedhjet e rregullta lokale do të mbahen ende kur rreziku nga pandemia nuk ka kaluar. Andaj, edhe

kujdesi duhet të jetë i shtuar dhe me shumë përgjegjësi nga të gjithë të përfshirët në procesin zgjedhor. Një proces demokratik nuk duhet ta rrezikojë shëndetin publik, andaj ju bëj thirrje të gjitha subjekteve politike, kandidatëve për kryetarë komunash dhe asamble komunale, deputetëve dhe të gjithë pjesëmarrësve në procesin zgjedhor respektoni masat, vaksinohuni, mbani distancën, takohuni në ambiente të hapura, ende kemi ditë me mot të mirë. Ruani veten dhe të tjerët dhe shpëtoni jetë!

Gjithashtu, uroj që ky Parlament në sesionin vjeshtor të mos bëhet arenë e ndeshjeve dhe promovimeve për zgjedhjet lokale. Pushtetet janë të ndara, jemi legjislativ. Ju uroj punë të mbarë të gjithëve dhe uroj të punojmë në dobi të qytetarëve të Republikës! Faleminderit!

KRYETARI: Tash fjalën e ka kryetari i Partisë Demokratike, deputeti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Të nderuar qytetarë,

Kryetar i Kuvendit,

Kolegë deputetë,

Kabinet i Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Meqenëse është seanca e parë e sesionit vjeshtor të Kuvendit, që në fillim dëshiroj t' ju uroj të gjithëve punë të mbarë në agjendën që e kemi para vetes si deputetë!

Por, meqë është seanca e parë pas një periudhe pushimi, që ishte periudhë tragjike për jetën e qindra qytetarëve tanë në ballafaqim me pandeminë, për çfarë u shpreh ngushëllime të gjitha familjeve që humbën më të dashurit e tyre, nuk mund të lë pa thënë se për punë të mbara nuk mjaftojnë uratat, as fjalët dhe as dëshirat. Për punë të mbara kërkohet reflektim, angazhim dhe ballafaqim me përgjegjësitë që kemi gjithsecili prej nesh. Reflektim, angazhim e përgjegjësi, pikërisht këto cilësi që nuk i kemi parë t'i ushtrorë kjo Qeveri gjatë kësaj periudhe.

Çdo qeveri e përgjegjshme dhe e ndërgjegjshme një ballafaqim të tillë me rrethanat pandemike, në të cilat gjendemi sot, do të duhej ta kishte shtruar në një rrafsh social e kombëtar e kurrsesi politik, në një rrafsh të bashkëpunimit e jo të refuzimit, sepse pasojat tragjike dhe rrethanat e rënduara për qytetarët nga pandemia nuk janë çështje politike, janë çështje publike dhe emergjente.

Pushteti mund t'i takojë dikujt në një kohë të caktuar, por publikja na takon të gjithëve në çdo kohë, prandaj edhe kemi përgjegjësi për të e rreth saj. Pikërisht për shkak të kësaj përgjegjësie ndaj gjendjes së rëndë që kishim gjatë dy muajve të fundit, unë iu drejtova me një letër kryeministrit Kurti për t'i ofruar bashkëpunimin tim dhe të Partisë Demokratike të Kosovës, madje duke ftuar dhe partitë e tjera opozitare që të ulemi së bashku e të gjejmë mundësi dhe alternativë për një përgjigje shumë më efikase ndaj rrethanave të rënduara.

Megjithëse isha në fillet e drejtimit të Partisë Demokratike të Kosovës, unë nuk doja të ndiqja shembullin që ka vendosur vetë zoti Kurti, duke krijuar ndasi politike për shkak të qëndrimeve partiake dhe për tema të rëndësishme nacionale, sepse një model të tillë e kemi parë dhe e kanë parë të gjithë qytetarët e Kosovës. Një model i tillë prodhon kriza, por nuk zgjidh kurrfarë krize. Prandaj, përballë kësaj nevojë emergjente, unë pashë në drejtim të Kosovës e jo në drejtim të partisë që drejtoj, sepse Kosova është emëruesi i përbashkët i të gjithë neve.

Prandaj, kam besuar e besoj se përballë kësaj gjendjeje do të duhej të ishim një front i përbashkët përtej politik. Por, kryeministri Kurti refuzoi një angazhim të tillë të përbashkët, nuk kishte as vëmendje, as përgjigje, as iniciativë. Ndërsa, numri i vdekjeve rritej e bëhej treshifror çdo javë. Përballë këtij refuzimi e mosreflektimi në këto rrethana, gjërave dua t'u vëmë emrat e tyre përkatës. Ishte keqmenaxhimi i Qeverisë shkaku që prodhoi këto pasoja. Ishte keqadministrimi i Qeverisë shkaku që jemi ndër të fundit në Evropë në procesin e vaksinimit, ndërsa hedhim vakcina që u skadon afati pa i administruar. Ishte keqplanifikimi i kësaj Qeverie që ka lënë qindra profesionistë shëndetësorë të paangazhuar e të pambështetur në ditët më të ngarkuara të punës së tyre dhe pa asnjë dyshim, ishte leximi i gabuar i krejt rrethanave paralajmëruese rreth rrezikut të variantit DELTA, pikërisht në kohën kur kjo Qeveri e kishte lëshuar për tokë obligimin për ta menaxhuar rrezikun e përhapjes së këtij varianti, sepse Qeveria i hapi në verë dasmat dhe ahengjet për të na i mbyllur në vjeshtë shkollat dhe çerdhet. Pra, përgjegjësia për këtë gjendje i takon vetëm kësaj Qeverie.

Por, edhe pse ne nuk do t'i mbyllim asnjëherë sytë përballë dështimeve që kanë shkaktuar këtë gjendje, nuk do të bëhemi kurrë oportunistë politikë kur është në pyetje shëndeti i qytetarëve. Prandaj, unë besoj që edhe sot duhet një front i përbashkët për t'ua lehtësuar qytetarëve tanë ballafaqimin me pandeminë COVID-19, sepse ndonëse fatmirësisht ka filluar të bjerë numri i rasteve, nuk ka asnjë garanci që gjendja nuk mund të rëndohet përsëri më vonë.

Dhe, kur jemi te qytetarët, ata më 17 tetor do të vendosin për qeveritë e tyre lokale. Është e domosdoshme që ata të kenë mundësi të zgjedhin e të përcaktohen mirëfilli për kandidatët, në të cilët besojnë se u përgjigjen nevojave të tyre. Është mirë që fushata t'u lihet kandidatëve, atyre që u takon përgjegjësia e llogaridhënia para qytetarëve të komunave të Republikës së Kosovës. Dhe, është më së mirë që temat e politikës qendrore t'u japin përparësi temave të politikës lokale në katër javët e ardhshme, ashtu që fokusi i këtyre zgjedhjeve vërtet të jenë qytetarët dhe interesat e tyre. Detyrat tona këtu në Kuvend, por sidomos në Qeveri, në radhë të parë duhet të jenë të fokusuar në parandalimin e mëtejshmë të përhapjes së dëmit të pandemisë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën nga Lidhja Demokratike e Kosovës e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Qytetarë,

Kabinet qeveritar,

Do të ishte shumë e mirëseardhur që të fillojmë sesionin vjeshtor me punët që na presin dhe me detyrat që i kanë deputetët e këtij legjislativi. Mbi të gjitha, me përgjegjësitë që t'u shërbejmë interesave të qytetarëve të vendit. Por, fatkeqësisht edhe sot pas një vere të zymtë, pas një vere që la shumë pasoja, ne duhet së paku të shprehim ngushëllimet për të gjithë qytetarët tanë që humbën më të dashurit e tyre në betejën me COVID-19, po mbi të gjitha humbën besimin e shpresën nga papërgjegjësia, nga keqmenaxhimi, më mirë të themi, nga mosmenaxhimi fare i tërësishëm dhe nga heqja dorë e menaxhimit me pandeminë COVID-19.

Paralajmërimet tona të singerta në muajin qershor dhe në fillim të korrikut, Qeveria jo vetëm që i neglizhoi, por filloi edhe duke u tallur, ashtu siç ishte tallur, ashtu siç kishte përdorur pandeminë vitin e kaluar, ashtu siç kishte tentuar edhe të sabotonte punën e institucioneve shëndetësore, po mbi të gjitha edhe të Qeverisë, në kryerjen e detyrave shtetërore për t'i dalë zot shëndetit publik të qytetarëve tanë.

Pikërisht më 2 gusht, kur ishte hedhur alarmi në rajon dhe në mbarë botën se varianti DELTA ka përfshirë masë të madhe në shpërndarjen e infeksionit dhe do të jetë i pranishëm në Kosovë, kryeministri Kurti dhe ministri i Shëndetësisë dolën edhe para këtij Kuvendi, ta them me një gjuhë, ndoshta nuk është edhe shumë etike, duke u krekosur se pandemia ka marrë fund dhe qytetarët mund të ndihen të lirë që të jetojnë dhe të veprojnë pa mbikëqyrje të masave, pa kufizime dhe pa kujdes të veçantë në ruajtjen e shëndetit publik.

Çka prodhoi kjo? Kjo prodhoi pasoja të tmerrshme. Këto pasoja u evidentuan edhe në masat e papërgjegjshme. Masat më të papërgjegjshme që do të jenë njollë në institucionet tona, edhe shëndetësore, edhe publike, edhe qeveritare, janë masat e 11 dhe 12 gushtit, kur infeksioni u dhjetëfishua e Qeveria prapë vazhdoi me relaksim të masave. Largoi punëtorët shëndetësorë dhe inspektorët në mbikëqyrjen e masave dhe u fsheh dikuj, ku vetëm këta e dinë, pa e pasur as vëmendjen më të vogël se çfarë po ndodh me humbjen e jetëve të qytetarëve tanë, me stërngarkimin e kapaciteteve spitalore dhe me çka mund të përballeshin edhe profesionistët shëndetësorë.

Qeveria u adresua në një formë tjetër. Filloi kritikën për opozitën, kaloi te qytetarët për shkak të mbipopullimit, ose të dasmave, ose aktiviteteve të tjera dhe në fund akuzoi edhe institucionet profesionale shëndetësore. Në fund të fundit, u detyrua për shkak të presionit që ta pranojë gabimin. Por, a e pranoi përgjegjësinë? Jo. Se, njerëzit e papërgjegjshëm nuk mund ta pranojnë përgjegjësinë. Ministri i Shëndetësisë u tregua shumë i papërgjegjshëm, nuk e pranoi përgjegjësinë, por e pranoi gabimin, e gabimi kushton. Këtë gabim do të duhej ta merrte për bazë edhe vetë kryeministri me shkarkimin e këtij ministri të Shëndetësisë, i cili u tregua skandaloz në rajon dhe në mbarë Evropën, duke e bërë Kosovën vendin më të tmerrshëm në ranglistat

botërore, në lista të zeza, duke e shndërruar Kosovën në 40-minutësh të vdekjeve dhe humbjeve të jetës së qytetarëve tanë dhe pa asnjë fije dyshimi u zhduk në javën kryesore më të rëndë, kur kishim humbje të jetës së njerëzve, deri në 36 jetë shumë të vlefshme, që pasojat e tyre i bartin së pari familjet, por edhe shoqëria.

Të nderuar kolegë deputetë,

Është e vërtetë që kërkesa jonë për frontin e përbashkët në luftimin e pandemisë asnjëherë nuk ka reshtur. Kërkesa jonë që qytetarët tanë të vaksinohen edhe nga ajo papërgjegjësia e hedhjes së vaksinave, asnjëherë nuk ka reshtur, por edhe dora jonë që të shtrijmë bashkëpunimin dhe të ofrojmë atë modesti të vogël në tejkalimin e kësaj situatë. Mbi të gjitha, dikush duhet të jetë përgjegjës.

I nderuar kryeministër,

Duke marrë për bazë se edhe shumë shtete të tjera demokratike kanë kaluar me pasojat, por nuk e kanë anashkaluar papërgjegjësinë, ky ministër është treguar i papërgjegjshëm. Andaj, duhet ta shkarkoni dhe të na kërkonin falje publike neve dhe të gjithë familjarëve që kanë humbur jetën nga masat, nga mosmbikëqyrja e masave dhe nga relaksimi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka Ramush Haradinaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Pushtetarë,

Bashkëndiejmë me ata që kanë humbur të dashurit e vet. Vonë është thirrja në përgjegjësi, ose në reflektim. Ajo që është më kryesorja, të ftohen qytetarët të vaksinohen dhe po ashtu t'i respektojnë masat, ta ruajnë shëndetin e vet, sepse me sa duket, duhet të kujdesen për vete, se Qeveria nuk ka qenë këtu të kujdeset për ta në mënyrën e duhur.

Ndërsa sot, po e shfrytëzoj rastin, meqë është kryeministri këtu. Unë, kryeministër, kam pyetur tre ministra tuajt, është e Drejtësisë, është ministri i Transportit dhe ministri i Rendit, për “Babën e tenderëve”, për një kryehajn, që emrin e ka Nexhat Krasniqi, sipas këtyre tre ministrave. Edhe i pyes në çdo seancë, sa herë që mundem, nuk më kanë dhënë përgjigje.

Kur kam qenë kryetar Qeverie në pyetjen e parë që ma kanë bërë, ju kam dhënë përgjigje. Kam shkuar, jam interesuar për pyetjen e tyre, i kam respektuar si deputetë, kam shkuar menjëherë, jam interesuar për pyetjen e tyre edhe e kam gjetur kush është personi. Ka rezultuar që ai është larguar prej pune. Tani, nuk e di të vërtetën e këtij njeriu, por po ju pyes juve, a e dini ju për Nexhat Krasniqin që më kanë pyetur tre ministrat tuaj, a është Nexhati ende “kryekriminel”,

“Baba i tenderëve”, e ku di unë, apo është i mirë ai, apo ju, kryeministër e tre ministrat tuaj jeni më të këqij se Nexhati. Do t’ ju shkruaj edhe një letër për këtë.

Edhe një pyetje tjetër, por këtë e kam për dy shokë të mi, Fatmir Humollin - Bacin dhe Gani Krasniqin. Të dy dua t’i pyes, qysh ka kaluar Liburni në Beograd dhe çka është puna e këtij korridorit të hekurudhave si diçka e re? Faleminderit!

KRYETARI: Tash, nga Partia Demokratike fjalën e ky kryetari i këtij grupi, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kryeministri i Republikës në dialog duhet të shkojë për njohje dhe ulëse në OKB dhe kurrsesi nuk mund të shkoni për ta redaktuar të vërtetën e historisë sonë si popull dhe si shtet. Për dy dekada me radhë Serbia dhe partnerët e saj nuk kanë reshtur së sulmuari kauzën e luftës sonë për çlirim. E në vend se Qeveria jonë t’u kundërvihet këtyre përpjekjeve, pavetëdijshëm ajo sikur po u kontribuon atyre. Po e them “në mënyrë të pavetëdijshme”, sepse nuk kam as vullnet, as imagjinatë, aq sa për të besuar se po e bën në mënyrë të qëllimshme, ngase fundja Qeveria dhe njerëzit e saj pavarësisht se nuk janë të aftë për të qeverisur, sërish janë bashkëkombësit e saj, qytetarë të këtij vendi, që e dinë të vërtetën dhe e ndajnë historinë së bashku me të gjithë ne.

Ndonëse Qeveria jonë është e pavëmendshme dhe e pavetëdijshme, një skenar i tillë dhe një agjendë kundër të vërtetës së luftës sonë është evidente dhe gjithnjë e më shumë aktive. Natyrisht, fjala është për pretendimet rreth arkivave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Rreth kësaj teme s’kam çka flas, sepse kur nuk ka subjekt, nuk ka as trajtim. Por, megjithatë dua të flas për agjendën si të tillë.

Të nderuar kolegë,

Ju kujtohet deklarata e kryeministrit pas darkës me Borellin, ku tha që Ballkani Perëndimor duhet të çlirohet nga kriminelët e luftës, pra pa pasur guximin që këtu ta apostrofojë Republikën tonë. Pastaj, duke vazhduar me deklarata denigruese të ministres sonë të Jashtme, zonjës Shvarc, në raport me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe, së fundmi, deklaratën skandaloze dhe të papritur të zëvendëskryeministrit Bislimi për arkivat e UÇK-së. Pra, këto të tria përbëjnë një trekëndësh, që s’do të duhej të ekzistonte kurrë nga qeveritarët tanë.

Kryeministër, po ta përkujtoj që kriminelë të luftës janë Milosheviqi, Dikoviqi, Papkoviqi, Lazareviqi, Arkani, Marjanoviqi, Lukiqi e shumë e shumë të tjerë, që kanë komanduar, urdhëruar dhe kryer krime, si dhe kanë drejtuar banda vrastare në luftën në Republikën e Kosovës.

Pra, ju kryeministër, duhet të kërkoni nga Vuçiqi që të hapen arkivat për mbi 400 masakra të kryera në Kosovë, rreth 14 000 civilë të vrarë, mijëra të zhdukur, të cilët edhe sot na mungojnë rreth 1630 dhe mbi 20 mijë gra të dhunuara. Pra, i nderuar kryeministër, mos ia legjitimoni Serbisë ankesën, se dëshmi për krime të luftës që paska kryer UÇK-ja gjenden në Prishtinë dhe Qeveria e Kosovës është e gatshme t'i hapë ato. Është e papranueshme të negociosh me Serbinë, duke rënë në grackën e saj për tema inekzistente, që fatkeqësisht tashmë ke rënë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Shtojani pak kohë, ju lutem!

ABELARD TAHIRI: Si deputet dhe qytetar, kërkoi nga Qeveria që të mos e devijojë agjendën e dialogut në temat që shpik Serbia dhe armiqtë e saj. Pra, në dialog duhet të kërkohet njohja nga Serbia, anëtarësimi ynë në OKB. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lëvizja Vetëvendosje, fjalën e ka deputeti Armend Muja.

ARMEND MUJA: I nderuar Kabinet qeveritar,

Kryeministër,

Deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Siç e do rendi, unë fillimisht u shpreh ngushëllime të gjithë atyre që kanë humbur më të dashurit gjatë pandemisë.

Megjithatë, përderisa është detyrë e opozitës t'i poentojë pikat e dobëta dhe të përqendrohet te kritika konstruktive, megjithatë është rendi që kur të kthehemi t'i potencojmë disa gjëra se çka ka ndodhur në tetë muajt që po lëmë pas. Fillimisht Kosova ka disa lajme të mira, sidomos tek aspekti ekonomik dhe ajo që duhet të lumturojë qytetarët e Kosovës është se rritja ekonomike në 8 muajt e fundit vlerësohet të jetë diku në versionin konservativ rreth 7% për disa arsye, sepse është dyfishi çfarë ne kishim planifikuar. Është larg përtej mesatares ballkanike, po gjithashtu edhe larg përtej rritjes ekonomike në Bashkimin Evropian, që vlerësohet të jetë 2%. Aktiviteti biznesor po ashtu është shtuar. Në tetë muajt e fundit kemi regjistruar rreth 9000 biznese të reja. Rreth 1300 më shumë se çdo vit, që nga viti 2012. Kosova po ashtu ka filluar të eksportojë. Në vitin, në tetë muajt që po lëmë pas kemi eksportuar 450 milionë euro, që është dyfishi krahasuar me vitin 2020 apo trefishi krahasuar me vitin 2019.

E rëndësishme është që ritmi i rritjes së eksporteve e tejkalon ritmin e rritjes së importeve. Gjithashtu, Shqipëria për herë të parë është bërë partneri i parë tregtar në rajon, si në import, ashtu edhe në eksport.

Ajo që duhet theksuar, po ashtu, është që besimi qeveritar është manifestuar edhe me rritje të të hyrave buxhetore. Që nga ardhja e Qeverisë Kurti për çdo muaj janë inkasuar rreth 200 milionë euro në buxhetin e shtetit, që është diku rreth 40 milionë euro më shumë sesa vitin 2019 e rreth 60 milionë euro më shumë sesa vitin 2020. Pra, kjo rritje prej 30% të hyrave buxhetore nuk është vetëm krahasuar me vitin 2020, po është edhe krahasuar me vitin 2019. E fundit që duhet të potencoj është të hyrat, investimet e huaja direkte. Kosova duket se është bërë vend tërheqës edhe për investimet e huaja direkte. Në këta tetë muaj i kemi regjistruar afërsisht 300 milionë euro investime të huaja direkte, që është rreth dyfishi më shumë sesa çdo vit tjetër, që nga viti 2014.

E fundit në sesionin vjeshtor të vitit të kaluar, Kosova ka regjistruar 200 mijë punëkërkuar aktivë dhe ajo që është e rëndësishme, duhet të theksohet se ky numër ka rënë në 100 mijë, që është një shenjë se po ashtu tregu i punës është stabilizuar me rritjen ekonomike.

Si përfundim, diaspora ka kontribuar jashtëzakonisht shumë gjatë kësaj kohe, qoftë përmes shpenzimeve gjatë vizitave të tyre, po ashtu...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vetëm ta përfundojë fjalën deputeti.

ARMEND MUJA: Diaspora ka qenë një kontribuues kryesor i kësaj rritjeje ekonomike. Si përfundim, besimin qytetar nuk e kemi tradhtuar. Gjatë viti 2021 nuk është dyfishuar vetëm Vetëvendosja, por si duket janë dyfishuar edhe parametrat ekonomikë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën nga Lidhja Demokratike e ka deputetja Marigona Geci.

MARIGONA GECI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar,

I nderuar kryeministër,

Unë si deputete e Lidhjes Demokratike në Kuvendin e Republikës së Kosovës jam munduar t'i përcjell me vëmendje zhvillimet politike aktuale brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, të paktën politika që ndërlidhen me Republikën e Kosovës.

Ju, zoti kryeministër, në pesëmuajorin e fundit keni vizituar disa shtete të rëndësishme, duke përfshirë këtu Republikën e Turqisë, Greqinë dhe Francën. Tani, ju kryeministër i Republikës së Kosovës, për të dytën herë dhe shqetësimet e mia janë rreth marrëdhënieve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Sipas informatave publike,

tashmë e kemi të qartë se për vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë udhëtuar presidentja, zonja Osmani dhe ministrja e Punëve të Jashtme, zonja Gërvalla.

Unë si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës shpreh shqetësimet e mia. Dëshiroj ta di për ju si kryeministër i Republikës së Kosovës se a keni aplikuar për vizë për t'i vizituar Shtetet e Bashkuara të Amerikës bashkë me presidenten dhe ministren e Punëve të Jashtme? Nëse po, në cilën datë keni aplikuar dhe çfarë përgjigje keni marrë? Dhe nëse jo, a mund të na tregoni pse deri më tani nuk keni vizituar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur dihet se në bisedimet që tanimë kanë filluar dhe ju jeni duke i shtjelluar bashkë me Republikën e Serbisë, roli i SHBA-së, qoftë edhe i tërthortë, është i pazëvendësueshëm.

Tani, presidentin Biden e kemi mikun më të madh të të gjithë shqiptarëve dhe mikun më të madh të Republikës së Kosovës dhe duke e ditur se promotori kryesor i lëvizjeve politike në botë, në Ballkan dhe në Kosovë gjithsesi janë vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nuk është as Turqia, as Greqia, as Franca, ne Lidhja Demokratike kemi qenë, jemi dhe do të jemi gjithmonë për ruajtjen e përhershme të miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Po besoj se e keni kuptuar se për çfarë jam duke folur.

Zoti kryeministër,

Edhe aksioni juaj i sotëm në veriun e Kosovës pa mbështetjen amerikane dhe në kohë fushate të zgjedhjeve lokale është i ngjashëm me atë të ish-kryeministrit Thaçi. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën tash e ka kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Duke dëgjuar kolegen time Mimoza Kusarin dhe kolegun tim Armend Mujën, jam duke pyetur veten a jetoj unë në Kosovë dhe a janë këta njerëz në këtë vend? Të dalësh në foltore të Parlamentit të Kosovës e të flasësh për menaxhim të mirë të pandemisë, kur je në listën e zezë të krejt Evropës, kur i ke pasur vdekjet më të mëdha në kursin ndërkombëtar, kur i ke dërguar në bërlllok 139 mijë vaksina, kur s'e ke hapur asnjë qendër në të gjitha komunat, kur s'ke në institucione publike maska e dezinfektues e kur ua ke dhënë 60 euro mjekëve e motrave medicinale, për mua është habia më e madhe. Kthjelluni, kryeministër, kryej këto punë, e para.

E dyta, për te ekonomia. Kur dora e shtetit shkon në ekonomi, kur i jep numrat dhe subvencionet që e ke ndihmuar ekonominë drejtpërdrejt, këtu është kur duhesh të lavdërohesh dhe flet për politika ekonomike. Ekonomia është ngjallur falë njerëzve të zotë, të cilët mezi e lidhin profitin muaj me muaj në sektor privatë të vogël dhe të mesëm. Subvencionet tuaja, shtesat tuaja, që ju u thoni "dilni merrni" e u tregoni pastaj që fillojnë në 2022-tën, nuk janë asgjë tjetër veçse një

manipulim. Ekonomia e Kosovës është buzë kolapsit, i dashur ministër, në qoftë se ju nuk intervenoni në dimër.

Ekonomia e Kosovës ka funksionuar falë industrisë së ndërtimtarisë, që punon gjithandej dhe falë gastronomisë, e cila ka punuar për shkak të masave. Në moment kur të prishet koha, gastronomia është në kolaps, industria e ndërtimit është në shtëpi. Andaj, uluni, përgatituni, e kemi rishikimin buxhetor.

Edhe e fundit, nuk e di a është ministri Sveçla. I nderuar ministër Sveçla, po e shfrytëzoj rastin edhe juve po ju them “kryeministër”. E kam një lutje për ju. A keni mundësi Ligjin e pagave të na e sillni në Kuvend. Ky ligj, në qoftë se nuk vjen në Kuvend për një kohë të shpejtë, nuk do të fillojë zbatimin në praktikë në vitin 2022, për shkak se nuk do të mund të buxhetohet. Për këtë jua jap fjalën që do ta keni mbështetjen time personale në çfarëdo kapaciteti dhe grupit parlamentar, të gjitha votat do t’i japim për kalimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Ka kaluar koha e deklarimeve jashtë rendit të ditës. Tash është koha e Qeverisë, nëse dikush do që ta marrë fjalën. Kryeministri Albin Kurti.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës,
Të dashur qytetarë të Kosovës,

15 shtatori i vitit 2021 ishte afati i fundit kur përfundimisht duhej të përmbylej marrëveshja e arritur në Bruksel dhe të ndalohej qarkullimi i veturave me çfarëdo nga tabelat, përveç atyre “RKS”. Republika e Kosovës nga data 15 shtator 2021 ka ndërprerë dhënien e tabelave “KS”, sepse nga kjo datë këto tabela më nuk janë valide.

Pesë ditë pas skadimit të afatit të paraparë sipas marrëveshjes mbi lëvizjen e lirë, Ministria e Punëve të Brendshme sot ndërmori veprimet e nevojshme për konfiskimin e të gjitha tabelave ilegale brenda territorit të Republikës së Kosovës, sikur edhe në të gjitha pikat e kalimit kufitar.

Pavarësisht se çfarë nacionaliteti janë poseduesit e makinave me tabela jovalide, ato po konfiskohen. Në të gjitha pikat e kalimit kufitar të Republikës së Kosovës, automjetet që mbajnë tabela të Serbisë dhe hyjnë në territorin e Kosovës do të pajisen me tabela të përkohshme.

Një marrëveshje teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që arritur në vitin 2011, pra ajo për lëvizjen e lirë, e që u finalizua në Bruksel më 14 shtator 2016. Që nga ajo kohë, Kosova ka zbatuar të gjitha detyrimet, përfshirë edhe lehtësimin e procesit për regjistrimin e automjeteve. Është kompletuar infrastruktura administrative për lëshimin e dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e automjeteve. Janë bërë edhe plotësimet dhe ndryshimet ligjore për të lehtësuar regjistrimin e automjeteve nëpërmjet një sërë veprimesh.

Një ndër këto veprime ishte zgjatja e validitetit të tabelave “KS” për 5 vjet, përkatësisht deri më 15 shtator 2021, kur ishte paraparë të jetë afati i fundit i heqjes nga përdorimi i këtyre tabelave, sikur edhe i tabelave me akronimet “KM” (për Mitrovicën e Kosovës), “PR” (për Prishtinën), “UR” (për Ferizajn), “PZ” (për Prizrenin) dhe “GL” (për Gjilanin).

Të dashur qytetarë e të nderuar deputetë,

Si kryeministër i të gjithë qytetarëve të Kosovës, ju siguroj se veprimet e ndërmarra sot nga organet kompetente për zbatimin e kësaj marrëveshjeje për lëvizje të lirë nuk janë të drejtuara kundër qytetarëve serbë.

Ato në asnjë mënyrë nuk kanë për qëllim t’ua cenojnë të drejtën e lëvizjes së lirë qytetarëve serbë, apo të provokojnë çfarëdo destabilizimi. Sikur dje, sot por edhe nesër, qytetarët serbë do të lëvizin lirshëm, të sigurt dhe të mbrojtur nga ligji dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga unë si kryeministër i saj. Pres nga të gjithë qytetarët që ta kuptojnë drejt se sot nuk po ndodh asgjë e jashtëligjshme apo diskriminuese. Sot vetëm po fillon zbatimi i një marrëveshjeje për të cilën është pajtuar Serbia me ndihmën e Bashkimit Evropian, sepse liria e lëvizjes është edhe e drejtë njerëzore e civile, por edhe vlerë evropiane.

Andaj, i lus qytetarët serbë të vazhdojnë ritmin e përditshmërisë, pa shqetësime dhe brenga se po u cenohet ndonjë e drejtë.

Ju të gjithë jeni qytetarë të barabartë të këtij vendi, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

Barazia për ne është vlerë të cilën e zbatojmë në praktikë dhe le të angazhohemi së bashku për të mirën tonë të përbashkët.

Në fund, më lejoni vetëm të tregoj se si ky trajtim i barabartë bëhet me këto tabela të përkohshme, të cilat nuk janë dëshirë e jona, por imponim nga pala tjetër.

Pra, këto janë tabelat tona që janë të përkohshme për ata të cilët vijnë me tabela të tjera, ndërkaq ka 10 vjet që qytetarët tanë paguajnë për këto tabela që janë poshtë. Ne nuk i duam as këto, as këto, mirëpo derisa të ketë këso, do të ketë edhe këso. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Lidhur me ato që u diskutuan... Njëherë le të flasim edhe ministrat lidhur me atë që u diskutua dhe pastaj me radhë. Nuk është kurrfarë problemi. Metodën e zgjedhim ne, sepse jemi deputetë të këtij Kuvendi. Fjalën lidhur me atë që e tha kryeministri e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Këto duartrokitje për këtë temë nuk dëgjohen për herë të parë në këtë Kuvend, i kemi dëgjuar edhe më herët. I kemi dëgjuar edhe më herët, kur kryeministri i vendit e pati shpallur po në të njëjtën mënyrë pompoze dërgimin e Forcave Policore të Kosovës në Veri. Nuk është se ne nuk pajtohemi me rend dhe ligj, por duhet ta dimë pikësëpari pse sot, zoti kryeministër? Pse me njësi speciale? A ka pasur ndonjë fushatë vetëdijesimi? A është dashur të dihet...? Ju përgëzoj për lumturinë, të nderuar kolegë deputetë, po qytetarët... e di që po merrni urdhra për të bërë zhurmë, po çka të ju bëj? Qytetarët e këtij vendi, qofshin ata...

KRYETARI: Qetësi, ju lutem, deputetë?

ARBEN GASHI: ...qytetarë serbë apo të komuniteteve tjera, duhet ta dinë pse po merret një vendim, duhet të dihet pse po bëhet një veprim dhe duhet të dihet cilat janë pasojat. Por, ai shou këtu që e bëri kryeministri, duke treguar targa, është thjesht një shou që është parë edhe më herët, e që është bërë nga kryeministri Thaçi. Pra, një krahasim banal i veprimeve që bëhen këtu.

Por, le të kthehemi te prioritetet që i kemi. Prioritet i këtij vendi është pandemia dhe për tri javë, zoti kryeministër, të kanë vdekur 604 qytetarë. A ke diçka të thuash për këtë punë? Ktheju kësaj pune! Ajo është detyrë normale, që e bëjnë pikat kufitare. Kurrkush nuk mund të hyjë në Kosovë pa i respektuar rregullat e këtij vendi, por ti ktheju pandemisë. 604 vetë kanë vdekur. Këtu po të presim, këtu përgjigju.

Ndërsa, sa u përket targave, le t'i zbatojnë pikat kufitare dhe në rregull jemi. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri Kurti për një përgjigje.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Po e ritheksoj se masat të cilat i ka ndërmarrë Policia e Kosovës sot janë krejtësisht në përputhje me Ligjin dhe kushtetutshmërinë, nuk ka asnjë teprim nga ne. Çfarëdo tjetër do të ishte gabim. Dhjetë vjet qytetarët e Republikës sonë kanë paguar për tabela provuese të përkohshme në mënyrë të padrejtë. Pra, trajtim të barabartë po bëjmë, jo kundër dikujt, ose për inat të ndonjërit.

Sa u përket disa prej pyetjeve që m'u bënë këtu, unë po u përgjigjem atyre, ndërkaq disa të tjerave do të mund t'u përgjigjen ministrat e linjës.

Së pari, jemi ulur bashkë me presidenten e Republikës, zonjën Vjosa Osmani, me ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, zonjën Donika Gërvalla-Shvarc, dhe me kryeparlamentarin Glauk Konjufca, në mënyrë që vizitat jashtë vendit t'i koordinojmë, që të mos ndodhë të jemi të gjithë ne, ose shumica, jashtë vendit. Nganjëherë na imponohet që edhe shumica të jemi jashtë

vendit, por nuk do të lejojmë asnjëherë që të gjithë ne të jemi jashtë vendit. Asnjëri prej nesh nuk e ka prioritet udhëtimin vetjak karshi dobisë së përgjithshme. Në këtë kuptim kemi vendosur që në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, që mbahet tash rregullisht në fund të shtatorit, të shkojnë presidentja e vendit dhe ministrja e Punëve të Jashtme. Pra, unë nuk kam aplikuar për vizë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse nuk e kemi pasur synim që të shkoj në këtë. Mirëpo, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të udhëtoj në nëntor. Pra, në muajin nëntor do të udhëtoj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bëhet fjalë për koordinim të brendshëm, që unë besoj se është i duhur dhe i mirë për shtetin tonë.

E sa për miqësinë me presidentin Biden, ju e dini që unë jam kryetari i vetëm i një subjekti politik që e ka mbështetur paraprakisht dhe publikisht, në ndërkohë që ju të tjerët keni shikuar se kush po fiton. Unë e mbaj mend shumë mirë muajin tetor. Ju keni qenë duke shikuar se kush po fiton, e unë dola publikisht, u bëra thirrje edhe shqiptaro-amerikanëve, u thashë “votojeni presidentin Biden”.

Dhe tjetra, sa i përket çështjes së dialogut me Serbinë - dialogu me Serbinë e ka përjetuar barazinë e padrejtë në trajtimin e palëve, sa i përket edhe luftës, shumë herë më herët, jo nga unë, përkundrazi, tash është duke u rregulluar. Dhe, në veçanti, do t’jua kisha kujtuar deklaratën e ish-kryetarit të partisë suaj, e ish-presidentit dhe ish-kryeministrit, në konferencën në Allt-Bah, kur thotë bashkë me Vuçiqin “We are not problematic guys”. Këtu është problemi. Ai barazohet, flet në emër të të dyve. Aty e keni marrë teposhtën, por tash po shkojmë përprjetë.

KRYETARI: Lidhur me këto që i tha kryeministri, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Respektimi i një marrëveshjeje që e ka arritur kryeministri Thaçi për targat, kjo tregon se sa je i përkushtuar ndaj dialogut dhe sa je i disiplinuar ndaj këtyre marrëveshjeve. Pra, ti je duke e vazhduar një dialog dhe po e respekton një marrëveshje që është arritur para 5 a 6 vjetëve dhe shumë mirë. Ne të përgëzojmë dhe mos u zbraps prej këtij vendimi. Është shumë me rëndësi të qëndrosh, është shumë me rëndësi t’i informosh qytetarët që nuk është karshi qytetarëve serbë, apo asnjë nacionaliteti tjetër, qofshin ata boshnjakë, apo çfarëdo tjetër. Mirëpo, qëndroni dhe mos u zbrapsni prej këtij vendimi.

Çështje tjetër që është e rëndësishme mendoj se duhet të keni konsideratë për qytetarët tanë në Luginën e Preshevës. Pra, gjithmonë, ata nganjëherë bien edhe viktimë prej të dyja palëve, edhe prej vendimeve të Qeverisë së Kosovës, edhe të Qeverisë së Serbisë. Pra, duhet ta keni një konsideratë që t’i trajtoni e që të mos kenë vështirësi qytetarët tanë që jetojnë në Luginën e

Preshevës për ardhjen e tyre në Republikën e Kosovës. Të paktën, të mos kenë taksa shtesë që duhet paguar për këto tabela shtesë, apo çfarëdo tjetër.

Çështje tjetër që është e rëndësishme, je kryeministri i parë i këtij vendi, fatkeqësisht, dy herë që shkon në Bruksel dhe e bën temë çështjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo është e dëmshme. Kjo s'ka qenë asnjëherë. Hashim Thaçi si kryeministër dhe president i vendit nuk e ka pasur kompleks Serbinë, sepse ka qenë fitimtar i luftës. Fatkeqësisht, sot neve na udhëheq një njeri që është viktimë e atij regjimi. Unë kisha dashur që ti të ishe luftëtar, çlirimtar, por s'je, je viktimë, fatkeqësisht. As viktimë s'kisha pas qejf të jesh, po qe, je viktimë. Pra, ti komplekset tua nuk mund t'i shërosh kaq lehtë, kanë për të të përcjellë sa të jesh në politikë, sepse Hashim Thaçi ka qenë fitimtar i luftës, ti je viktimë e atij regjimi, kuptojë një herë e përgjithmonë. Kjo ka për të përcjellë gjatë, ka për të munduar, e kuptoj, por jeto me këtë tash, çfarë ke të bësh, je viktimë e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri Kurti e ka fjalën!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Kur fola për respektimin e marrëveshjeve të Brukselit dhe për zbatimin e tyre, nuk fola me pietet për përmbajtjen e marrëveshjeve, por fola për atë që Serbia është ajo, e cila e ka kundërshtuar zbatimin dhe respektimin e atyre që i kanë nënshkruar vetë. Pra, në raport me Serbinë unë përmend respektimin dhe zbatimin e marrëveshjeve, jo afirmim pozitiv i ndonjë farë vlere të madhe që paska përmbajtja e tyre, kjo është e para.

E dyta, në shtetndërtimin tonë demokratik problemi që është instaluar në raport me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, është se ajo është lënë jashtë Deklaratës së Pavarësisë së Kushtetutës së Republikës, ky është thelbi. Nëse luftën çlirimtare e lë jashtë dokumenteve themeltare, natyrisht që do të ketë pasoja. Ju mund të keni dëshirë që unë të kem komplekse, por për besë unë s'kam kurrfarë kompleksesh. Pra, dëshirën tuaj mos ma përshkruani si fakt timin.

Mos u fshihni pas Preshevës që të kërkonit prej meje të mos sillemi si shtet. Në Kurtin 1 kemi ndarë fond 500 mijë euro, për vërshimet në Preshevë, 100 mijë euro, çfarëdo dëmi që do të kenë nga zbatimi i masave qytetarë tanë atje, ne do të gjejmë mënyra e mekanizma për t'i korrigjuar ato. Kështu që, mos u brengosni as për këtë gjë.

KRYETARI: Zoti Tahiri, më duhet po ashtu t'juaj tërheq vërejtjen lidhur me fjalën që e patët më herët. Mendoj që është e turpshme dhe nuk i takon këtij Kuvendi të Republikës së Kosovës të dëgjojmë dallime të tilla në Kuvendin e Kosovës. Ndarja e asaj çka na ka ndodhur gjatë luftës, në viktima të pavlera dhe në luftëtarë me shumë vlere, kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të lejohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe nuk duhet të jetë në gojën e asnjë deputeti të Republikës së Kosovës, i cili është zgjedhur prej qytetarëve të Kosovës.

Natyrisht, që kemi qenë edhe viktimë të regjimit të Milosheviqit dhe në Kosovë ka mijëra viktimë, zoti Tahiri, që i kanë përjetuar krimet e Serbisë e nuk e kanë zgjedhur t' i përjetojnë ato. Ka edhe luftëtarë, ka edhe dëshmorë, po duhet ditur ti që secili e ka vendin e vet. Nuk duhet kurrfarë dallimi, bash kurrfarë dallimi në atë aspekt. Edhe ky ishte një gabim i madh që e bëre, të lutem, mos e përsëritni më, së paku këtu në këtë Kuvend. Çka mund të bësh në studio televizive e në rrugë, është tjetër gjë. Po, urdhëro!

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë bashkëndjej dhe ndjem keq pa dyshim edhe për kryeministrin tonë që ka qenë viktimë e atij regjimi, sikur për të gjithë ish të burgosurit, sepse normalisht kanë qenë të përvuajtur, e kemi përjetuar secila familje, të gjitha ato dhimbje që ka shkaktuar regjimi serb.

Dhe, nuk i gëzohet askush, mos na moralizoni, sepse nuk e thashë në atë drejtim, mirëpo thashë se unë kisha dashur që ky të jetë një çlirimtar, një luftëtar i lirisë dhe jo kjo që është sot. Prandaj, po e them prapë, nuk po e keqpërdor dhe asnjëherë s'e keqpërdor, pra bashkëndjej dhe normalisht sikur një i ri, si një 16-vjeçar kam protestuar edhe për lirinë e tij në vitin '99. Pra, unë si një gjimnazist i "Xhevdet Dodës" kam protestuar edhe për lirinë e tij. Prandaj, nuk e keqpërdorim, mos na moralizo, se është e padrejtë t'i japim këndvështrim tjetër një deklaratë të tillë, mos e keqpërdor. Pra, të gjitha ato viktimë, të gjithë ata njerëz që kanë dhënë kontribut për lirinë dhe pavarësinë e vendit, pa dyshim që i njohim dhe u përkulemi për angazhimin e tyre. Mirëpo, në asnjë rrethanë nuk e thashë për keqpërdorim, thashë ky e përmendi Hashim Thaçin dhe e bëra një krahasim mes tij dhe Hashim Thaçit, kjo është. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri Kurti e ka sërish fjalën për këtë temë.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Unë e kam të qartë se po përpiqeni të përçani, ju mund të vazhdoni të përpiqeni të përçani, por nuk ndahet populli qysh po e mendoni ju. Prandaj edhe ka votuar siç ka votuar më 14 shkurt të këtij viti. Nuk mund ta përçani e ta ndani popullin në luftëtarë të paepur dhe në viktimë, të cilët në hierarkinë e vlerave tona nuk janë në rend të parë, është e padrejtë.

E dyta, a ka qenë Adem Demaçi në UÇK? Epo nëse ka qenë Adem Demaçi UÇK, unë kam qenë sekretari i tij. E, a kam qenë në UÇK, pyete Sylejman Selimin dhe Rustem Mustafën, dy komandantë. Njëri komandant i Zonës Operative të Llapit dhe tjetri komandant i Zonës Operative të Drenicës dhe më pastaj komandant i përgjithshëm. Pyeti këta të dytë dhe të tregojnë, ama pushoni me këtë idenë, pushoni me këtë idenë e përçarjes e të ndarjes. Dhe, a e kuptoni, pra dëshirën tuaj mos ma përshkruani si fakt mua, edhe po e humbni kohën e parlamentarizmit, edhe po bëni shpërqendrim prej çështjeve jetike të qytetarëve.

KRYETARI: Zoti Tahiri, s'po e di sa votues i ka PDK-ja, po ti do të ishe i fundit që do të duhej të flisje për vlerat e UÇK-së. Ka plot në PDK të tjerë që mund të kallëzojnë kush është luftëtar i paepur e kush është UÇK-ja, e çka është UÇK-ja, po ti ma merr mendja në listë i fundit duhet të jesh diku.

Urdhëro, e ke një replikë me kryeministrin!

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë pa dyshim që jam prej atyre të parëve që duhet të flas, pikërisht sepse si një djalë i ri, si një 15-vjeçar në luftë, që e kemi përjetuar atë terror, atë tmerr, sikur familja ime, sikur të gjitha familjet e Kosovës, prandaj sot ti nuk mund të bësh cilësime të tilla dhe keqpërdorime të tilla. Mos e keqpërdor foltoren e Parlamentit të Kosovës!

Kryeministër, sinqerisht kisha pasur dëshirë që ti të ishe ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kisha dashur jashtëzakonisht shumë, asnjëherë s'të kemi parë në uniformë, asnjëherë s'të kemi parë në zonat e luftës, asnjëherë s'të kemi parë duke folur në emër të UÇK-së, asnjë deklaratë nuk e ke në emër të UÇK-së, ke përkthyer për një njeri shumë të madh qysh është zoti Adem Demaçi, që i përulemi të gjithë punës, angazhimit, sakrificës të tij. Ai ka qenë, pra, një drejtor politik, pastaj Hashim Thaçi pas tij. Prandaj, të lutem, tregona edhe një herë cili ka qenë angazhimi yt në luftë për çlirimin e Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Glauk Konjufca!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Më datën 9 shtator kam mbajtur një konferencë për media në ambientet e Qeverisë së Kosovës, ku mes tjerash kam deklaruar si vijon: 'Pala serbe, të paktën deklarativisht, ka thënë se janë dakord të hapin të gjitha arkivat. Sipas tyre, kjo nënkupton të hapen edhe arkivat shtetërorë të Kosovës që kanë të bëjnë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës'.

Mendoj se kjo fillimisht është në interes tonin, për arsye se shumica e varrezave masive, ku pretendohen të jenë në varreza, e informata kanë kryesisht arkivat ushtarake të Serbisë. Kjo ka qenë deklarata ime, pas kësaj deklaratë një mori liderësh politikë të PDK-së, duke filluar nga kryetari i tanishëm dhe i perkohshëm Memli Krasniqi, kryetarja e ardhshme Vlora Çitaku, nga Ganimete Musliu e të tjerë, edhe Bekim Kamishi, se po të harroj ty në këtë grup, kanë nisur një

valë të tmerrshme të sulmeve dhe shpifjeve, duke thënë se ne po hapim arkivat e UÇK-së. Si zëvendëskryeministër i Republikës së Kosovës unë kam vetëm akses në arkivat shtetërorë...

KRYETARI: Zoti Bislimi, më shumë respekt për kryetarët e partive...

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI: ...nuk kam akses në arkivat private të dikujt tjetër. Të gjithë ju e keni ditur këtë, por megjithatë keni nisur një valë të madhe të sulmeve, të paprecedent, kundër personalitetit tim, duke thënë se unë po hap arkivat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Më 16 shtator, zoti Lajçak ju ka demantuar sërish dhe ka thënë, si vijon: “Zëvendëskryeministri Bislimi ka thënë se s’ka arkiva të UÇK-së, por vetëm arkiva shtetërore të Kosovës”. Ju i keni thënë zotit Lajçak, por normalisht se detyra jonë është të kritikojmë qeverinë në takim që keni pasur me të. Po, por kritika e Qeverisë nuk bëhet me shpifje, nuk bëhet me gënjeshtër, me shantazhe, nuk bëhet duke nxitur valë të kërcënimeve. Njerëzit kanë mbajtur burg për shkak të kërcënimeve ndaj meje si rezultat i shpifjeve tuaja. Sot, kryetari i grupit tuaj parlamentar pa pikë turpi doli këtu dhe prapë tha se ke folur për arkivat e UÇK-së, edhe pas demantimit që i ka bërë vetë zoti Lajçak. Është e turpshme se deri në ç’masë mund të shkojnë me shpifje, me gënjeshtër për tema për të cilat edhe dokumentohet në vazhdimësi se janë inekzistente, veç nuk e di ku e keni fundin. Pra, mungesën e turpit ju e keni privilegj.

Sa i përket marrëveshjes për lëvizjen e lirë, nuk ka marrëveshje nga data 15 shtator, nuk ka marrëveshje. Marrëveshja që ju e keni nënshkruar nga viti 2011 ka skaduar më 15 shtator 2021. Po jua rikujtoj vetëm pikën tre të marrëveshjes: “Qytetarët e Serbisë që udhëtojnë në ose nëpër Kosovë do të pajisjen me dokument hyrje-dalje”. Kjo është bërë në vitin 2011, a mund të më tregojnë të gjitha partitë që keni qenë në qeverisje nga 2011 sa qytetarë të Serbisë që kanë kaluar në ose nëpër Kosovë i keni pajisur me dokumente hyrje-dalje. Sa prej tyre i keni pajisur ju që keni thënë se këto marrëveshje janë të mira dhe e integrojnë Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Tash, fjalën ia japim Ramush Haradinajt, pastaj zonja Geci, sepse me siguri që lidhet me temën që po e trajtojmë.

RAMUSH HARADINAJ: Po dal që të them që edhe kryeministri, ashtu si zonja Kusari, edhe si deputetë të tjerë është dashur të hapet diskutimi pas pushimit në këtë Parlament me një ngushëllim për viktimat e pandemisë, më erdh çudi që nuk e mendoj edhe ai të nevojshme, edhe me siguri i ka ikë. E pashë që i ka dhënë shumë vlerë ngjarjes së sotme në kufi, unë e përshëndes zbatimin e Kushtetutës dhe të ligjeve tona, të gjithë kufijtë e vendit, nuk është mirë të lidhen me fushatën, në të kaluarën i kemi kritikuar të tjerët kur kanë ndodhur veprime të tilla se mos kanë të bëjnë me fushatën, nuk po dyshoj që është fushatë, por megjithatë e kuptoj dhe besoj që serbët e Kosovës nuk kanë pasur ndonjëherë qeveri më të mirë se Qeverinë Kurti, ua ka paguar rrymën,

11 milionë, nuk janë pak. Për pesë euro të këtyre tabelave t'ua bëjmë diqysh, më vjen keq prej kosovarëve tonë, po s'kemi çka t'ju bëjmë.

Domethënë, u kthyen në kushtetutshmëri, në ligj, të mos e lidhim me fushata. Diçka për zotin Bislimi, se ky vërtet është një zyrtar i Qeverisë së vendit që është duke i bërë shumë dëme kësaj qeverie, këtij kryeministri dhe vendit tonë me papjekurinë e tij, nuk dyshoj që ka ndonjë qëllim të keq. I pyeti tha sa qeveri keni dhënë listat hyrjet-daljet, domethënë deri kur kam qenë unë në qeveri nuk ka qenë në fushatë, por s'ka hyrë gati kurrkush se e kemi pas vendosur taksën 100%.

KRYETARI: Tash, ministri Vitia e ka fjalën. Mirë, të gjithëve do t'ju vijë radha. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryetar!

Nuk kam pasur shumë vërejtje në mënyrën se si i ke udhëhequr mbledhjet në të kaluarën, por sot besoj që keni dalë prej rolit që e keni të jesh i pari në mesin e të barabartëve dhe nuk ju takon juve që të jepni as cilësime, as vlerësime, e aq më keq që të keqinterpretoni qëllimshëm deklaratat e kujtdo qoftë, siç ishte rasti i deklaratës së zotit Tahiri, që e ndërruat kontekstin totalisht pikërisht për të arritur atë që ishte qëllim edhe i kryeministrit që të zhvendoset tema nga çështjet për çka u diskutua e të krijoni pikërisht ju përçarje.

Ju ndoshta keni ardhur të koordinuar këtu bashkë me kryeministrin e zëvendëskryeministrin, e me deputetët tuaj pikërisht për të shkaktuar përçarje edhe për të konfliktuar diskutimet këtu, por ky s'është qëllimi ynë. Atë e shpreha edhe në fjalën time. Ndërsa, zoti Bislimi përdorni shumë terminologji të rëndë kur dilni të flisni në Kuvend, realisht nuk i takon dikujt që e konsideron veten profesor dhe që e ushtron këtë rol në kohë të lirë.

Por, t'ju them të drejtën, shpifjet i bëtë ju. Unë nuk ju marrë më juve, në fakt, sepse me gjithë respektin njerëzor, nuk ju konsideroj të rëndësishëm, ju kam injoruar, sepse nuk mendoj që ju keni kurrgjë në dorë, jeni një korrier i kryeministrit. Domethënë, përgjegjësia juaj është përgjegjësia e korrierit, kështu që unë nuk kam telashe me juve si person, dhe kjo është arsyeja që ju kam injoruar, ju shpifët se unë s'jam marrë me juve, as emrin s'jua kam përmendur kurrë, dhe ndoshta në të ardhmen edhe pahiri mund t'jua përmend, por shpifja që e bëtë këtu, keni imunitet, pa dyshim, por ishte një gënjeshtër për çka nuk ju ka hije si profesor.

KRYETARI: Ju lutem edhe një herë si deputet, mos ma merrni për të keq një këshillë që po dua t'jua transmetoj. Kur flisni për njëri-tjetrin dhe për përgjegjësitë e njëri-tjetrit që i keni ligjore në kuadër të shtetit të Kosovës, janë pozita të Republikës së Kosovës, nuk janë pozitat tona personale, mos përdorni terma denigrues për njëri-tjetrin, nuk i takon nivelit të Parlamentit të Kosovës, për të gjithë po flas që po flasim për njëri-tjetrin, po mundohen ta zhvleftësojnë në

terma degradues njëri-tjetrin, në nivel të pozitive që i mbajnë. Ju lutem, të rezervoheni nga këto cilësime.

Zoti Bislimi, e keni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI: 9 shtator 2021, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, i ka reaguar zëvendëskryeministrit të Kosovës, Besnik Bislimi, i cili tha se hapja e arkivave të UÇK-së në këmbim të hapjes të atyre të Serbisë është në favor të Kosovës. E shenjtë, e pastër, e përhershme, e paprekshme është UÇK-ja.

Ti nuk je marrë me mua apo thua nuk je marrë, si s'po të vjen marre të thuash nuk jam marrë?! Memli Krasniqi reagoi pas dhe faleminderit për injorimin që ma keni bërë deri tash, uroj që të më injoroni edhe në të ardhmen, por unë mendoj se për momentin edhe më i vlefshëm në Kosovë është një korrier i Kryeministrit Kurti se sa një kryetar i PDK-së.

KRYETARI: Këshillën time mund ta përsëris edhe njëqind herë në Kuvend të Kosovës, por nuk ka nevojë, atë që e thashë, ma merr mendja që do të respektohet edhe prej deputetëve, edhe prej anëtarëve të qeverisë.

Një minutë për zotin Krasniqi, po do të sqarojë atë që e tha zoti Bislimi.

MEMLI KRASNIQI: Pikërisht çka ju thashë, zoti Bislimi, as s'jua kam përmendur emrin e shpresoj që s'jua përmend për shkak të parëndësisë që e përfaqësoni, e para. Logoja e UÇK-së, e postuar në faqen time, nuk ka të bëjë me juve, nëse ju e konsideroni logon e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si reagim ndaj jush, po më vjen keq, po edhe Vasfija e paska logon e UÇK-së, mos është duke të reaguar edhe kjo ty pse e ka ngjitur logon e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mos e mbivlerëso veten, jo që s'ka pasur të bëjë kurrgjë me ty, por me asnjë prej juve. Ka pasur të bëjë me bindjen time që ajo është logoja më e bukur dhe më e rëndësishme në historinë e shqiptarisë, prej që ka shqiptarë mbi tokë. E, ti nëse këtë e ke marrë reagim ndaj teje, me të vërtetë nuk mendoj që mund të të ndihmoj unë, ndoshta ndokush tjetër mundet, unë jo

KRYETARI: I kemi kaluar disa minuta jashtë kohës së paraparë të kësaj pike, kështu që po propozoj të kalojmë te pyetjet parlamentare.

Po më vjen keq, po u zgjat shumë kjo pjesë e temës së parë. Nëse pajtoheni që ta zgjasim këtë pikë, atëherë i keni edhe të drejtat e replikës. Mirë, po pastaj edhe deputetët, zoti Aliu, e kanë të drejtën të kundërvihen. Ministri Liburn Aliu e ka fjalën.

MINISTRI LIBURN ALIU: I nderuar deputet, zoti Haradinaj,
I ngritët disa çështje. U ngrit çështja e Nexhat Krasniqit.

Nexhat Krasniqin e ka kthyer organi më i lartë në vendin e tij të punës para se të vij unë ministër. Ju po thoni pse s'po e largoni atë prej pune. Unë s'largoj njerëz prej pune, sepse jam ministër. Nëse unë do të kisha larguar njerëz prej pune, unë bëj shkelje ligjore. Kjo mënyra që ju e thatë që unë ta largoj atë prej pune drejtpërdrejt kjo i bie të goditet shteti.

Proceduralisht i vjen mundësia e trajtimit kur të bëhet rregullorja e Ministrisë për bashkim të ministrive dhe pastaj zgjidhet në mënyrë procedurale, të rregullt, sipas Ligjit të shërbyesve civilë. Po qe se unë përziej unë në këtë çështje, unë bëj shkelje ligjore dhe e godas së pari shtetin e Kosovës.

E dyta, ia bëtë pyetjen deputetit Fatmir Humolli për një çështje që ka të bëjë me mua. Pra, ju po i bëni pyetje deputetit Fatmir Humolli, jam këtu unë. Unë jam ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, jam këtu dhe mund t'ju përgjigjem drejtpërdrejt.

Për sa i përket deklaramit tim në Beograd, ka të bëjë me linjën hekurudhore Prishtinë-Durrës. Pra, meqenëse planifikohet që Durrësi të jetë port, i cili do të zhvillohet, është jetike për Republikën e Kosovës që të lidhet me linjë hekurudhore me Durrësin.

Por unë do ta kisha ngritur një çështje tjetër. Pse nuk është kjo temë në tavolinë? Pse unë s'e kam pasur asnjëherë, ju keni qenë në qeveri përpara, pse unë nuk e kam pasur asnjëherë në tavolinë çështjen e korridorit hekurudhor Durrës-Prishtinë. Keni qenë aty, është dashur të ishte kjo punë e kryer, është dashur ne tash veç ta fillonim punën.

Pse prej jush trashëgoj unë vetëm disa çështje, e trashëgoj rrugën Prishtinë-Nish, e trashëgoj hekurudhën Prishtinë-Leshak-Serbi. Pse nuk e kam një korridor të vetëm gjatë kohës së juaj që na lidh me Shqipërinë.

Për shembull, pse nuk ka së paku një rrugë tjetër që na lidh, ndërshqiptare. Ju e përmendni rrugën Deçan-Plavë, po pra, Deçan-Plavë. Gjemani dokumentin ku ju jeni marrë vesh me Qeverinë e Malit të Zi për atë rrugë. Pra, ajo nuk është rruga Deçan-Plavë, ajo është rruga Deçan-Bjeshkë, i kam kërkuar të gjitha dokumentet, nuk ka një letër të vetme që ju jeni marrë vesh me Malin e Zi ose keni biseduar që ta çoni atë rrugë deri në Plavë. A po themi ne të bëjmë rrugën Prishtinë –Tetovë. Tri herë jam takuar me ministrin e Maqedonisë së Veriut, tri herë jemi takuar me drejtorin e Drejtorisë së Rrugëve, jemi takuar me ministrin e Financave, ministri ynë i Financave është takuar me ta, nesër do të shkoj dhe do ta bëjmë fije për pe, është nënshkruar edhe marrëveshje në mes të dy kryeministrave për ta bërë atë rrugë.

Pra, kur themi Prizren-Tetovë, Tetova është në Republikën e Maqedonisë dhe duhet dikush prej asaj pale që të merremi vesh, duhet tunel, bëhen rrugë dhe merremi vesh edhe për detaje. Pra, duhen dy palë. Ju keni thënë rrugën Deçan-Plavë, kjo është shumë e rëndësishme. Por asnjë letër nuk është, asnjëherë asnjë takim, asnjë procesverbal, pse na keni mashtruar.

Pse na keni mashtruar për rrugën Deçan-Plavë, kur unë s'jam duke gjetur asnjë letër. Ju lutem, ma gjeni letrën, mbase ju e dini. Po, keni pasur një takim me ministrin e Malit të Zi për Rozhajë, për Rozhajë po, për Rozhajë keni folur, për Deçan, për Rozhajë ke pasur dhe është përmendur tunel. Tregoni për rrugën Deçan-Plavë, se keni folur vazhdimisht, ku janë letrat, gjeni letrën, po e realizojmë projektin, nuk është rruga Deçan-Plavë.

Edhe çka është më keq tash të kalojmë në shkallën tjetër, është edhe më keq. Manastiri i Deçanit thotë: Rruga që kalon nëpër Manastir të Deçanit është rrugë regjionale dhe është në rregull, por meqenëse ju po e bëni rrugën Deçan-Plavë, ju duhet të kaloni me bajpas rreth e përçak 18 kilometra dhe çka ndodh, bëhet pastaj marrëveshja në atë komitetin e famshëm për zbatim dhe monitorim ku nënshkruhet për ta bërë atë rrugë anash. Pse? Asnjë letër, asnjë letër s'e keni në tavolinë për rrugën Deçan-Plavë, ku është ajo. Unë do t'i thërras qytetarët që e përfaqësojnë Plavën, Gusinë, Vuthaj të vijnë e të flasim konkretisht në mos ata dinë diçka, sepse ministrit të Malit të Zi dy herë ia kam ngritur këtë çështje.

Më 1 tetor do të takohem prapë me të, dy herë kam pasur takime me ministrin e Malit të Zi, dy herë e kam ngritur çështjen Deçan-Plavë, i kam thënë e kemi marrëveshjen, më ka thënë s'ka kurrfarë marrëveshje, po është projekti...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po zoti Haradinaj, urdhëroni!

RAMUSH HARADINAJ: Po më duhet të falënderoj që për herë të parë pas gjashtë muajve ia përmendi emrin Nexhatit. Po unë nuk e njoh, ndoshta është njeri i mirë, i kërkoj falje sot.

Po e di, i nderuar ministër, i nderuar ministër Liburn, je ministër i Transportit, ministër i Durmishit, aty e ke afër kolegen Albulena Haxhiu, pati kohë të shkojë në fushatë për burrin e vet në Malishevë, po ende s'e ka përmendur emrin e Nexhatit edhe ministri i Brendshëm Sfeçla, krejt mundësitë i ka pasur, po ende s'ia ka përmendur emrin. Arsye pse jua përmend këtë emër lidhet pikërisht me ju të tretë, ju ma keni kërkuar një llogari kur kam qenë kryetar qeverie, po e ushtroj funksionin e deputetit, po ju pyes, e pyeta edhe kryeministrin tuaj.

Ndërsa sa i përket Fatmirit dhe Ganiut, veç po ju them edhe një herë. A e patë një send shumë interesant. Unë e pyeta; qysh ke kaluar në Beograd për hekurudhën, m'i bëri nja gjashtë

kundërpyetje Liburni. Pra, pse, a thua? Pse Liburni kur e kam pyetur 100 herë për rrugën e Plavës, kurrë nuk më ka dhënë përgjigje, e pse sot ma dha, pra fshehu qysh ka kaluar në Beograd, kjo shpjegohet shumë thjesht.

Unë e kam hapur këtë rrugën e Plavës, i dashur Liburn, kur të punosh në atë territorin tonë, sa je në territorin tonë s'ke nevojë prej ndonjë shteti fqinj, këtë mësoje njëherë, kur të dush një lidhje me atë, vetëm atëherë e bën një kërkesë, shkurt, a bën se kemi një korridor, ka mbërritur deri në kufij tuaj, se e ke bërë me para tua brenda shtetit tonë, edhe rrugën e Tetovës, edhe rrugën tonë, sa janë në territorin tonë s'ke nevojë t'i kërkohet llogari askujt, i kryen aq sa je i zoti, kur vjen puna të lidhesh, i drejtohesh tjetërkujt nëse janë me fonde të tua.

Por ishte shumë domethënëse fakti se ju në vend që të përgjigjeni qysh kaluat në Beograd për këtë hekurudhën, ju e dini prej hekurudhave e çka ndodh...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti Aliu ka një përgjigje.

MINISTRI LIBURN ALIU: Unë një herë e sqarova shumë qartë, është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës që e ka kthyer Nexhatin dhe proceduralisht mund të trajtohet qysh t'i vijë rendi. Po ju përderisa vazhdimisht keni insistuar këtu, e ju e njihni më mirë se ne të gjithë, e para.

Edhe një herë po flasim për rrugën Deçan-Plavë. Kur të thuash rrugë Deçan-Plavë, Plava i bie në Mal të Zi, kur të thuhet rruga, njëjtë sikur kur të themi ne rruga Prizren-Tetovë, kur flasim për rrugën Prizren-Tetovë, unë nuk mund ta hapim gjysmën e tunelit, sepse gjysma tjetër e tunelit i takon Republikës së Maqedonisë së Veriut. Prandaj, mua më duhet të shkoj e ta takoj palën tjetër dhe të merremi vesh. Unë mund të them tash, për shembull, e filloj rrugën prej Prishtinës për Prizren dhe mendoj që lidhen e bëjmë më tej dhe themi kjo lidhje na çon neve me Stamboll, e kemi bërë marrëveshjen për Stamboll. Jo është Prizren-Tetovë, shumë e qartë, Prizren-Tetovë jemi kah...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Shtojani një minutë për një përgjigje ministrit.

MINISTRI LIBURN ALIU: Në Beograd nuk ka qenë lehtë, a e dini pse. Sepse ju keni bërë marrëveshje për Nish, keni bërë marrëveshje për Leshak, keni bërë marrëveshje tjetër, i keni tri marrëveshje, asnjë me Shqipërinë. Pra, mua m'u ka dashur t'ua bëj të qartë që këto nuk bëhen pa e bërë këtë të Durrësit. Prandaj, nuk ka qenë e lehtë, sepse ju keni folur një herë qysh të lidhemi me Nishin, keni folur qysh të lidhemi me Leshakun, me Beogradin, mua m'u ka dashur kundër

këtyre tri marrëveshjeve, tri linjave, pa e pasur një me Shqipërinë, m'u ka dashur t'u kundërvihem e të vendos në kundërpeshë linjën Durrës-Prishtinë, linja Durrës-Prishtinë, vendin ku është dashur të flitet më së miri e ka pasur pikërisht Beogradi në gjuhën shqipe. Faleminderit!

KRYETARI: Tash fjalën e ka Arben Vitia, ju lutem, lidhur me pandeminë. Po tash po zgjatemi shumë, zoti Selmanaj. Le të shpjegojë zoti Vitia gjendjen me pandeminë dhe pastaj vazhdojmë.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Faleminderit edhe juve zoti Krasniqi për fjalën në fillim kur treguat edhe një kulturë në raport me kërkesën për bashkëpunimin dhe jo refuzimin, në raport me situatën me pandeminë.

Ka qenë një muaj e gjysmë jashtëzakonisht i vështirë për të gjithë neve, për qytetarët e Republikës, ku shfrytëzoj rastin që edhe një herë t'u shpreh ngushëllime të gjithë familjarëve dhe miqve të rasteve që kanë përfunduar në mënyrë fatale në betejën me pandeminë.

Në anën tjetër, kërkesën për bashkëpunim, kërkesën për koordinim jo një herë, shumë herë nga kjo foltore e Parlamentit e kam bërë për çdo deputet, e jo vetëm për çdo grup parlamentar dhe ajo vlen akoma dhe do të vlejë çdo herë në Qeverinë Kurti.

Më lejoni që vetëm t'ju përmirësoj në një, po e quaj gabim teknik, ose ndoshta për shkak të mungesës së informacionit. Procesi i vaksinimit është duke shkuar jashtëzakonisht mirë, zoti Krasniqi. Kemi filluar të fundit për arsye që i dimë, mirëpo tani, siç jeni të informuar ju dhe qytetarët e Republikës, procesi i vaksinimit në Kosovë ka tejkaluar të gjitha vendet e rajonit për sa i përket numrit të dozave të administruara dhe përqindjes së popullatës së vaksinuar.

Dhe, prapë po e përsëris, edhe si grupe parlamentare, edhe si deputetë prapë është dera e hapur në Ministrinë e Shëndetësisë, prapë do të jetë dera hapur, sepse kjo është një luftë e përbashkët, sidomos në raport me variantin Delta, i cili, siç e ka treguar në krejt botën, jo vetëm te ne, është një lloj i virusit tjetër me agresivitet edhe të shpërndarjes, por edhe agresivitet të klinikës, duke mos i kursyer as moshat e reja. Por fatkeqësisht një numër i deputetëve, ashtu siç kam thënë, jo që nuk kanë qenë të gatshëm të bashkëpunojnë, mirëpo edhe janë munduar ta dëmtojnë në çdo moment procesin e vaksinimit.

Për pjesën tjetër të asaj çka u tha këtu nga disa deputetë, besoj që edhe nuk ia vlen të përgjigjem, sepse janë të gjitha shpifje, dhe të gjitha këto shpifje sinqerisht janë sqaruar me dhjetëra herë dhe nuk besoj që është e udhës të sqarohen edhe një herë kur janë të tilla.

Unë kam vetëm pasi ishte hera e parë ndoshta që u drejtua zoti Tahiri, ndoshta me prapë mungesën e informatave, ndoshta me shumë arsye të tjera, mirëpo këtu e keni edhe profesorin e nderuar doktor Shemsedinin, i cili ju kishte treguar që nuk është e vërtetë që nuk ka maska, dezinfektues, zoti Tahiri.

Për herë të parë prej kur ka filluar pandemia, pas një udhërrëfyesi të kostuar dhe të buxhetuar, kemi edhe Rendesivirin dhe shumë artikuj të tjerë që kanë qenë në mungesë gjatë gjithë kohës prej fillimit të pandemisë.

Në anën tjetër, më lejoni t'ju informoj edhe për disa çështje që u përmendën.

Falë masave të Qeverisë Kurti, Kosova po arrin ta kalojë variantin Delta, variantin më të rrezikshëm deri tani, më shpejt se sa dy muaj, akoma dy muaj nuk janë bërë nga fillimi i variantit Delta dhe ne jemi në përfundim.

Më lejoni t'ju përkujtoj Indinë, përmbi katër muaj. Mbretëria e Bashkuar, katër muaj deri tani, po vazhdon akoma. SHBA-ja tre muaj deri tani, po vazhdon akoma. Izraeli, tre muaj deri tani, po vazhdon akoma. Mali i Zi, dy muaj deri tash dhe po vazhdon akoma në mënyrë agresive, bile duke u rritur.

Ndryshe nga qeveritë e kaluara, Qeveria Kurti e ka dëshmuar veten të aftë për të vënë në kontroll të tri variantet e virusit deri më tani, në prill të vitit 2020 me masat që i kemi marrë vala e shkaktuar nga varianti fillestar është ulur pothuajse zero. E njëjta në periudhën prill 2021 dhe tani po ndodh prapë pas gushtit 2021.

Qeveria paraprake fatkeqësisht nuk është treguar e aftë në këtë menaxhim. Për shkak të masave të tyre joefikase dhe zakonisht jo të menduara mirë, nuk ka arritur të ulë kur rastet kaq shpejt dhe kaq thellë, përkundrazi gjatë javëve të fundit të Qeverisë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zgjatja edhe një minutë ministrit. Ju lutem, ministër, përmbliidheni nëse keni mundësi.

MINISTRI ARBEN VITIA: Kryetar, gjatë periudhës shkurt-mars 2021 nuk është ndërmarrë asnjë veprim përballë rritjes së rasteve, asnjë veprim duke çuar edhe në rritje të viktimave dhe në numër të rasteve.

Kështu që ne nuk jemi duke zbuluar ujin e nxehtë këtu, ne jemi duke marrë rekomandime të ekspertëve, po duke ndjekur edhe praktikat më të mira në vendet evropiane, edhe në Shtetet e

Bashkuara të Amerikës. Kur ka rritje të rasteve, natyrisht se masat merren ashtu siç i kemi marrë dhe prandaj atë që e dëshmoja, në çdo valë kemi arritur që sa më shkurt dhe sa më thellë të ulim numrin e rasteve dhe viktimave.

Është një situatë e rëndë, ju lutem, qytetarë, vaksinohuni, sepse edhe valë të tjera do të vijnë, pavarësisht cila Qeveri është, me këtë Qeveri më mirë, mirëpo çdo ministër...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Lidhur me këtë temë, e ka kërkuar fjalën Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Fjalën e kërkoja prej kur zoti zëvendëskryeministër ma përmendi emrin, por nuk ma dhatë. Unë më me ministrin e Shëndetësisë nuk do të flas për pandeminë, nuk ka kredibilitet më kjo Qeveri të diskutohet më për pandeminë, as për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, as për vaksinimin, as për mbështetjen për profesionistët shëndetësorë.

Do të doja të diskutoja këtë problem me një ministër kredibil që vërejtjet e deputetëve i merr seriozisht me kohë, që mbështetjen e deputetëve e merr dhe e trajton, e jo kur ai vetë dështon dhe i hedh në bërllok 133 mijë doza vaksinash, pastaj del dhe i akuzon deputetët për një të vërtetë, të cilën e kanë thënë se ke pranuar vaksina në kundërshtim me ligjin.

I nderuar kryeministër,

Për temën e sotme që e hape në fillim, pra për zbatimin e marrëveshjes së Brukselit për targa, do të duhej fillimisht të falënderoj Hashim Thaçin për vizionin e tij për shtetin që si opozitar e ke kritikuar këtë marrëveshje, ndërsa sot si qeveritar po mburresh me zbatimin e saj dhe duhet të thuhet ‘faleminderit, zoti Thaçi’ për vizionin për shtetin dhe ne sot në qeveri po zbatojmë vendimet e tij.

Për zëvendëskryeministrin unë jam Bekim Haxhiu, deputet i Kuvendit të Kosovës, në pesë mandate, kam pasur gjatë luftës nofkën “Kamishi”, atë nofkë dhe ajo nofkë u bë e njohur gjatë fushëbetëve, por i kemi përdorur si emërtim të dytë për t’u mbrojtur nga kumbarët e Serbisë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: 30 sekonda zotit Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: I kemi përdorur nofkat gjatë luftës për t’i mbrojtur familjet dhe të afërmit tonë nga kumbarët e Serbisë që sot po mundohen t’i hapin arkivat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilat nuk ekzistojnë dhe barazimi i arkivave inekzistente...

KRYETARI: Kaq ishte fjala juaj, z. Bekim Haxhiu! Mos e ofendoni askënd! Ndërpritjani fjalën deputetit, është ofenduese kjo që tha.

Tash, edhe Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën, pastaj ia japim edhe një herë fjalën ministrit të Shëndetësisë për një përgjigje përfundimtare.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar i Kuvendit,

Me të vërtetë, kjo tregon atë çfarë e thamë. Ky ministër e demanton vetveten, po nuk e dimë, në nënvetëdije e tregon të vërtetën për punën e vet, por edhe për përgjegjësinë që ka. Aq lehtë doli këtu, aq lehtë ecën mbi viktimat, aq lehtë shkel mbi punën e profesionistëve shëndetësorë dhe aq lehtë dhe me shumë relaks tregon që prapë u mund pandemia. Kjo është e papërgjegjshme, kjo është e frikshme për këtë njeri. Për një njeri i cili e ka përgjegjësi menaxhimin e pandemisë.

Ka pasur periudha kur pandemia është vënë më shkurt se kjo kohë në raste minimale, por ne nuk kemi treguar relaksim e çlirim të masave. Kjo është tepër e frikshme. Mos bëni krahasime të tilla. Në një vit kur nuk ka pasur asgjë, as arma më e fortë, vaksina. 45 ditë, 624 qytetarë, të rinj dhe të reja, nëna shtatzëna, fëmijë të mitur, të kanë vdekur para syve dhe del e thua që për 45 ditë po e vëmë nën kontroll variantin Delta. Kjo është e turpshme, është skandaloze. Janë duke të dëgjuar edhe partnerët ndërkombëtarë, edhe ata që e mbështetin Republikën e Kosovës dhe që e kanë mbështetur në ditët më të vështira. Mos kështu, mos se je duke i dërguar qytetarët drejt vdekjes. Prapë je duke i detyruar të mos vaksinohen, se nuk ka pandemi, s'ka virus, u mund varianti Delta. Ka katër muaj që varianti Delta ka ardhur në Kosovë. E kemi paralajmëruar. Të kemi thënë. Nuk e di se si funksionon me këtë logjikë. Mos, mos, mos! Ndërprite këtë logjikë. Më datën 11 i ke liruar masat, e ke shtyrë afatin e diskotekave, i ke dërguar njerëzit drejt vdekjes. Mos! Ky është gabim. Je duke luajtur me jetën e njerëzve.

KRYETARI: Ministri Vitia e ka fjalën.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryetar!

Zoti Zemaj, një prej arsyeve që nuk desha të ju përgjigjem paraprakisht është edhe për shkak të njohurive elementare që i keni në këtë fushë, sinqerisht, edhe për shkak të një situatë të cilën e keni krijuar, zoti Zemaj.

Ju thatë, arma më e fortë vaksina. Pse nuk kemi pasur vaksina, z. Zemaj? Kështu që, sinqerisht, çdo gjë që e thatë edhe tani është dezinformatë, shpifje, keqinformim.

KRYETARI: A mund ta ruani qetësinë, deputetë?

MINISTRI ARBEN VITIA: Deputeti Zemaj,

Nëse e keni aq me rëndësi shëndetin e qytetarëve, bëni thirrje për vaksinim vazhdimisht, z. Zemaj! Asnjëherë nuk i jeni bashkëngjitur kësaj. Lëre që nuk i keni siguruar vaksinat z. Zemaj, por as nuk keni bërë thirrje. Keni bërë absolutisht atë që nuk do t'i takonte, më fal, gati ju thashë profesionist shëndetësor, por nuk jeni, por nuk do t'i takonte asnjë qytetari të përgjegjshëm.

Në anën tjetër, jam i befasuar pak me z. Haxhiu, si profesionist në fushën shëndetësore, i cili prapë del dhe shpif, sepse vërejtjet e deputetëve i kam marrë parasysh z. Haxhiu, çdo herë, mirëpo jo shpifjet. Ju keni bërë shpifje, z. Haxhiu! Edhe kundër vaksinimit, edhe për procesin e vaksinimit, edhe për afatin e vaksinave. D.m.th. obstrukcioni të cilin ju e keni bërë, jeni munduar ta bëni, është i paprecedent, z. Haxhiu. Për një profesionist shëndetësor. Edhe ju lutem qytetarë të nderuar, mos u besoni disa doktorëve, besojuni doktorëve të vërtetë që po përballen në klinikat tona, besojuni doktorëve të vërtetë që po bëjnë thirrje për vaksinim!

KRYETARI: Faleminderit zoti Vitia! Tash nga një minutë e kanë z. Zemaj dhe z. Haxhiu.

ARMEND ZEMAJ: Ky njeri prapë po gabon. Nuk je mjek ti. Ti titullin e ke mjek. I vetmi mjek në Kosovë, i vetmi mjek që nuk e ka veshur mantelin në përballjen me pandeminë jeni ju ministër. Mund t'i thoni vetes mjek, i vetmi mjek, nuk ka tjetër. I vetmi dhe i fundit, dhëntë Zoti! Jo ministër! Kemi bërë thirrje në vazhdimësi. Më datën 23 e ke marrë mandatin, më datën 29 i ka pranuar vaksinat. Nuk i ke marrë me vete. T'i ka lënë dikush. Pas tri ditësh të ka ardhur kontrata. Ti duhet t'ua shpjegosh qytetarëve çka ke bërë me këtë kontratë që e ke mbyllur. Krejt i ke pasur: oksigjenin, shtretërit, testet, të gjitha i ke pasur, por menaxhim s'ke dashur të bësh. Spitalet i ke ngarkuar me pacientë, i ke larguar mjekët dhe infermierët. I ke larguar inspektorët sanitarë. Këto veprime i ke bërë. Këto kanë prodhuar pasojat.

KRYETARI: Zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Të them që më nuk ke kredibilitet të diskutosh për pandeminë. Vërejtjet që i kemi bërë këtu në Kuvend janë edhe pyetje parlamentare, janë të transkriptuara, kemi apeluar për vaksinim. Ndonëse të shtunave dhe të dielave s'ke vaksinuar, je rrezitur në det, edhe u ka skaduar afati vaksinave që i ke pranuar me kohë të shkurtër, në kundërshtim me ligje. Për këtë çështje është Prokuroria duke u marrë me ty. Po besoj që pastaj përgjegjësi do të vendoset përpara drejtësisë.

Sa i përket kësaj anës tjetër të kredibilitetit, ose shkollimit të doktorëve, unë po mendoj që ti e di që në universitetit ku unë kam doktoruar ti ke bërë dhjetë vjet ta kryesh dhe një specializim që e ke regjistruar para 16 vjetësh ende s'ke arritur ta kryesh. Ti je 'pick-up' doktor, doktor i barnave që shet barna.

KRYETARI: Z. Vitia e ka fjalën për një përgjigje të fundit.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, z. Konjufca!

24 800 vaksina z. Zemaj që i keni proklamuar që do t'i merrni qysh në janar ose diku, asnjë kontratë të gatshme, asnjë parakontratë të nënshkruar nga ju në Qeverinë e kaluar... Po qite! E keni qitur ju duke rrezikuar edhe shëndetin e... po natyrisht që ka pasur. 1,2 milion vaksina që kanë ardhur, ju i keni qitur. Parakontratë e cila nuk është bërë asgjë, z. Zemaj. Sinqerisht është e kotë të merrem me ju.

Në anën tjetër, z. Haxhiu, prapë po shpifni. Në universitetin ku ju e keni kryer fakultetin, unë nuk e kam kryer fakultetin. Unë e kam kryer fakultetin në një universitet tjetër. Është në CV-në time, në Tiranë, z. Haxhiu. Pyetini gjithë kolegët e mi, 1998-2003. Pyetini të gjithë kolegët e mi, edhe pyetini çfarë studenti kam qenë, edhe pyetini për të gjitha. Këto janë informata publike. Qysh janë për juve z. Haxhiu, qysh janë edhe për doktoratën e juaj z. Haxhiu, qysh janë të gjitha publike. Të gjitha janë publike, o z. Haxhiu. Vazhdoni e qitni në tavolinë çka të keni për Arben Vitinë. Por, jo me shpifje, e sidomos jo me shpifje që e dëmtojnë procesin e vaksinimit, z. Haxhiu. Kur z. Haxhiu keni dalë dhe u keni bërë thirrje qytetarëve për t'u vaksinuar, përveç që ju keni krijuar konfuzion në vaksinim.

Prapë, qytetarë të nderuar, mos u besoni teorive konspirative të cilat gjenden edhe në Parlamentin e respektuar të Kosovës. Vaksinohuni! Është i vetmi shpëtim! Nga 15 qershori mbi një milion doza të administruara. Ju lutem, mbajeni këtë ritëm!

KRYETARI: Ia japim fjalën e fundit edhe profesorit Shemsedin Dreshaj, deputetit të Kuvendit nga AAK-ja.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit kryetar i Kuvendit!

E nderuar Qeveri,

Unë nuk desha të flas, por meqenëse ministri ma përmendi emrin, atëherë unë fjalimin tim do ta rezervoj, për shkak se niveli i debatit nuk është duke më pëlqyer. Është nën çdo nivel. Do ta rezervoj dhe do të bisedojmë në Komisionin për Shëndetësi, kur të jemi bashkë me juve. Ky nivel i debatit vërtet nuk do të duhej të ishte një model i një seance publike, e cila shihet në mbarë vendin.

KRYETARI: Një minutë për z. Vitia lidhur me këtë që e tha deputeti Dreshaj për nivelin e debatit.

MINISTRI ARBEN VITIA: Profesor i nderuar!

Jam dakord me ju. Atë çka kërkova nga Grupi Parlamentar i AAK-së dhe atë çka kërkova nga ju personalisht është që vetëm të konfirmoni, nëse nuk është e vërtetë, nuk është e vërtetë dhe marr

përgjegjësi të plotë para qytetarëve. Kur thatë që nuk kemi as maska e as dezinfektues nëpër klinikat tona, e në Klinikën Infektive.

Unë vetëm e thashë atë që kemi maska të mjaftueshme, kemi dezinfektues dhe kemi edhe Remdesivirin për herë të parë, të cilin nuk e blen qytetari i Republikës qysh nga fillimi i pandemisë qysh e ka blerë, por tani shteti, Ministria e Shëndetësisë, Qeveria e kanë postuar dhe qytetarët e marrin pa pagesë nëpër klinikat tona të COVID-it. Faleminderit edhe për mirëkuptimin!

KRYETARI: Zoti Dreshaj, një minutë!

SHEMSEDIN DRESHAJ: Zoti ministër,

Nuk qëndron që unë kam thënë nuk ka maska. Ka pasur maska, por nuk ka pasur dezinfektues as në portën e hyrjes, as nëpër reparte brenda. Kam qenë, vetë i kam vizituar, kam marrë pjesë në procesin e vizitës brendapërbrenda reparteve. Unë ju përgëzoj për sigurimin e Remdesivirit, por dua t'ju them diçka. Veprimet e ndërmarra deri më sot nga kjo Qeveri janë vendime të vonuara, zoti ministër. Ju e dini fort mirë kur kam kërkuar vaksinën. Ju kam thënë ju mbështes. Ju e dini fort mirë kur kam kërkuar vaksinimin masiv. Ju kam thënë, ju mbështes. Ju e dini fort mirë kur unë kam kërkuar vaksinimin masiv të profesioneve që veprojnë me punëtorët e shërbimeve publike. E keni bërë me vonesë, zoti ministër. Arsimitarët, prapë me vonesë. Unë e di që vendimet ju i merrni bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

KRYETARI: Tash Gani Krasniqi ma ka kërkuar një sqarim. I kemi mbetur borxh. E ka kërkuar fjalën shumë moti.

Nuk e di pse e keni tërhequr fjalën.

GANI KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar Ramush Haradinaj, u konsultuam me Rregulloren e punës dhe kjo dihet mirëfilli që pyetja parlamentare i bëhet ministrit në fjalë, jo edhe deputetëve. Por, megjithatë, është e drejtë e juaja. Edhe pse u përgjigj ministri, unë po ashtu jam i obliguar për të dalë dhe për t'u sqaruar.

Nëse keni menduar për të bërë pyetje se Qeveria dhe ministri është imi, apo është i këtij Grupi Parlamentar, kjo vlerësoj se nuk është në rregull. Qeveria, ministri dhe komplet ekipi janë votuar dhe janë të këtij Kuvendi dhe në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Unë kujtoj se pikërisht këtu është një ndryshim i madh që tash të veprohet. Unë me Liburnin çfarëdo që kam në jetën private mund ta... përndryshe si punë e tij unë do ta parashtroj këtu në Kuvend, do ta

pyes në Kuvend Liburnin apo këdo, qoftë nga ministrat që e bëjnë Kabinetin e Qeverisë. Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Driton Selmanaj lidhur me ministrin Liburn Aliu.

DRITON SELMANAJ: Kryetar,

E para, unë nuk ju sugjeroj ta shkelni Rregulloren asnjëherë, por në ato raste kur të vendosni shkeljen e Rregullores, atëherë unë do të mendoj dhe besoj që duhet të jetë në favor të deputetëve dhe jo në favor të Qeverisë. Qeveria e ka institucionin tjetërkund, ky është institucion i deputetëve dhe si i tillë të lutem të na respektosh.

Tash, unë e kërkova fjalën në tematikën që ishte më herët dhe jo pasi doli krejt tema tjetër. Por gjithsesi po kthehem te ajo që dëshiroja të flisja.

Zoti Liburn Aliu, mund të them ta ketë tradhtuar edhe memoria, por në vitin e kaluar kur ne e kemi sjellë Marrëveshjen e Uashingtonit këtu, na ka sulmuar me gjuhën më të ashpër pse pjesë e Marrëveshjes së Uashingtonit është edhe fizibiliteti i hekurudhës për Shqipëri. Edhe na ka thënë po ia mundësoni daljen e Serbisë në Detin Adriatik. Ne kemi thënë: Si po mendoni ju, Kosova është stacioni i fundit ku duhet të ndalen krejt mallrat dhe krejt autostradat? Po ku është e mira e Kosovës që Kosova të jetë atraksion dhe të kalojnë të gjitha format e komunikacionit. Por, kritika e tij e ashpër, madje edhe fyese ishte që ne po i shërbejmë Serbisë, jo Kosovës dhe Shqipërisë. Dhe çfarë thotë sot? Kur shkon në Beograd dhe kthehet këtu, thotë kështu: Linja hekurudhore Prishtinë-Beograd nuk ka efekt nëse nuk e lidhim me Durrësin. A jemi duke folur për të njëjtën Shqipëri? A jemi duke folur për të njëjtin Det Adriatik? Apo për juve, një Shqipëri është tjetër në opozitë kur jeni, por një Shqipëri tjetër është kur jeni në pushtet. Apo Shqipërinë e shfrytëzoni për të shkuar të bëni protesta për ndërtimin e hidrocentraleve, sepse keni telashe për ekosistemin e tyre dhe ambientin e tyre, e në Beograd shkoni pa paralajmërim...

KRYETARI: Ministër, a ka mundësi të na jepni një përgjigje lidhur me dallimet konceptuale të Qeverisë paraprake në të cilën ka qenë Dritoni dhe kjo tuajën? Ajo është esenca nëse ka mundësi të na tregosh!

MINISTRI LIBURN ALIU: I nderuar deputet!

Në Marrëveshjen e Uashingtonit thotë: Lidhja hekurudhore ndërmjet Prishtinës dhe Merdarit, thotë lidhja hekurudhore ndërmjet Nishit dhe Prishtinës, thotë rruga ndërmjet Prishtinës dhe Merdarit. Në këtë rast, lidhjen me Durrësin ju nuk e keni paraparë. Ju nuk keni paraparë as takim të vetëm, të cilin ne shpejt do ta kemi. Ajo ku është dallimi esencial mes nesh dhe jush që sapo e parashtrij kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës është linja Prishtinë-Nish, që nuk duhet të bëhet, po duhet të bëhet linja Prishtinë-Durrës. Kur ta bëjmë linjën Prishtinë-Durrës mund të flasim për vazhdimin e asaj linje. Andaj dua të them, tri marrëveshje të ndryshme për linjat me

Serbinë, asnjë e vetme për lidhjen me Shqipërinë. Jo për ta gjetur arsyetim Durrësin, kur ta bësh marrëveshjen me Serbinë të thuash po e bëj, sepse në të ardhmen mendoj ta lidh me Durrësin, por lidhe me Durrësin, mandej mund të thuash që ndoshta në të ardhmen e lidhim me Serbinë. Pra, ti e ke përdorur Durrësin si pretekst për ta bërë marrëveshjen për ta lidhur Prishtinën me Nishin, ndërsa shumë thjesht ne themi duhet ta bëjmë linjën Prishtinë-Durrës, eventualisht pas kësaj mund të themi që edhe e lidhim me Korridorin 7, apo linjën hekurudhore nr. 7, për të cilën keni folur. Prandaj, kontrata hekurudhore Hani i Elezit - Leshak është në vazhdim, por kontrata Prishtinë-Nish, për të cilën ju jeni marrë vesh, nuk bëhet pa e bërë linjën Prishtinë - Durrës. Nishi mund të ketë qenë në kohën e Ilirisë.

KRYETARI: Nuk keni të drejtë më të bëni kundër-replika, por po jua jap nga një minutë. Urdhëro, z. Selmanaj!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Zoti Aliu, kujtohuni, nuk jeni më në opozitë që të shkëputni fjalë apo paragrafë jo të plotë dhe më pas të ndërtoni kauzë dezinformuese. Lexojeni komplet Marrëveshjen e Uashingtonit dhe flet për parafizibilitet dhe fizibilitet për dalje në Detin Adriatik, që Kosova dhe Shqipëria të lidhen me hekurudhë. Këtu qartësoje! Thuaje këtë! Lëre ti tash në fjalë dhe në fjali dhe më pas po bën lëmë shqip nga diçka e cila, po them dojeni shtetin edhe kur jeni në pushtet, edhe në opozitë. Nuk është shteti me korrespondencë, dashuria për shtetin. Por, duhet të jetë çdoherë dhe çdo kund.

KRYETARI: Zoti Aliu nëse i doni 60 sekonda si përgjigje përfundimtare.

MINISTRI LIBURN ALIU: Unë edhe njëherë jua sqarova kronologjinë e rrjedhave e të hapave sesi duhet të bëhet. Dhe mos harroni, edhe në Shqipëri, edhe këtu, linja Durrës-Prishtinë ka qenë e goditur në kohën e marrëveshjes dhe duhet të bëhet. Sot, prioritet, edhe sipas këtyre marrëveshjeve, është linja korridori Tivar-Beograd, ku ne lidhemi në atë korridor. Pra, prapë edhe Shqipëria, edhe Republika e Shqipërisë, edhe Republika e Kosovës me linja të veçanta të lidhen me Beograd nëpërmjet Malit të Zi ose nëpërmjet Leshakut lart, ose nëpërmjet variantit të Nishit në Korridorin 10.

Ajo çka po themi ne është shumë e qartë; lidhja me Adriatikun, jo nëpërmjet Tivarit, lidhja me Adriatikun bëhet me hekurudhën Durrës ose Porto Romano, ose në hekurudhën, e cila lidh Durrësin me Shkodrën, të bëhet kyçja nga Gjakova ose nga Prizreni, sepse ato gjurmë ekzistojnë...

KRYETARI: Zonja Geci, për çka keni dashur ta merrni fjalën? Tema më interesoi, jo prej kur... Me fjalimin e kryeministrit? OK! E keni fjalën.

MARIGONA GECI: Zoti kryetar!

E kam kërkuar fjalën menjëherë pas përfundimit të fjalimit të kryeministrit dhe nuk më është dhënë. Po ia jepni fjalën kujt po dëshironi ju vetë.

Sido që të jetë, dua të ndërlidhem me fjalimin e kryeministrit që na u drejtua neve.

Zoti kryeministër,

Ne nuk kemi shikuar se kush do t'i fitojë zgjedhjet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse Lidhja Demokratike e Kosovës, presidenti Rugova, i kanë betonuar marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe mjafton që ju vetëm t'i ruani ato raporte. Faleminderit!

KRYETARI: Tani e ka fjalën Bekë Berisha.

BEKË BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë e kam një pyetje për kryeministrin: Më pati pëlqyer shumë ideja e bashkimit kombëtar që e ka promovuar, edhe ka kohë që nuk ka ndodhur asgjë. Andaj, po kam qejf ta di se a ka lëvizur diçka në atë aspekt.

Si është e mundur Prindon Sadriu fill i vetëm ta veshë uniformën për këtë ide, ju jeni në koalicion, dhe ka mbetur vetë. Pse nuk po e përkrahni? Kur po e kryejmë këtë punë?

KRYETARI: Pal Lekaj e ka fjalën. Sigurisht lidhur me diskutimet e ministrit Vitia.

PAL LEKAJ: I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Për hir të opinionit publik dhe qytetarëve, por ndërlidhem në atë që e tha ministri Liburn Aliu sa u përket hekurudhave.

Është e vërtetë që ne si Qeveri Haradinaj dhe unë si ministër i Infrastrukturës kemi pasur tri takime me ministrin e Malit të Zi, me ministrin e Republikës së Shqipërisë, me ministrin e Maqedonisë dhe i kemi formuar komisionet respektive për të komunikuar sa i përket edhe rrugës për Rozhajë, dhe aty vetëm kishte filluar fizibiliteti për tunel, dhe sa i përket edhe rrugës tjetër që Manastiri nuk ka dashur që as ta nisim atë rrugë dhe kemi pasur shumë e shumë probleme.

Nuk është e vërtetë që Komiteti Ndërministror ka nënshkruar diçka të tillë sa i përket asaj trasesë tjetër, se nuk kam rënë dakord. Dhe, të vish këtu dhe t'i japësh përparësi Sekretariatit të

Komunitetit Rrugor në Beograd, ku marrin pjesë shtetet e regjionit dhe në atë drejtim të thoni dhe të krenoheni që ne kemi nënshkruar vetëm për hekurudhën Prishtinë - Durrës...

Më vjen mirë që e përmendët që është kryer edhe një fizibilitet sa i përket daljes në Shkodër nëpërmjet Gjakovës, sepse kanë qenë dy variante; edhe nëpërmjet Prizrenit...

KRYETARI: Zoti Aliu... Ka mundësi zoti Lekaj, si jo!

PAL LEKAJ: Edhe sa i përket kësaj, në Beograd është diskutuar sa u përket korridoreve pan-evropiane dhe jo korridoreve të të dyja shteteve, dhe duhet ta thoni të vërtetën.

Është e vërtetë që kjo nuk është diskutuar fare sa i përket... Nxirre marrëveshjen! Ju kisha lutur që ta nxjerrësh marrëveshjen dhe çfarë shkruan në atë marrëveshje, që është nënshkruar në Beograd. Të lutem, nxirre atë marrëveshje para qytetarëve! Po ju sfidoj! Por, jo të vini këtu dhe ta mashtroni opinionin publik. Faleminderit!

KRYETARI: Po më duket se ministri e pranon sfidën në fjalë.

MINISTRI LIBURN ALIU: I nderuar ish-ministër,
Në Beograd nuk ka pasur marrëveshje të nënshkruar, në Beograd ka pasur zotime në lidhje me... Jo, jo s'ka të bëjë fare kjo me korridoret.

Në Beograd ka pasur të bëjë me zotimet për hekurudha, për operabilitet mes vendeve të rajonit, dhe kjo ka qenë ajo. Nuk kanë qenë marrëveshje, madje kanë qenë zotime. Por, tema e hekurudhave dhe korridoreve të reja... Se ti e di shumë mirë që... S'e di a e di, se në bazë të asaj që e the, nuk e di a e di. A po kupton! Nuk po di, në bazë të mënyrë se si e formulove.

Korridoret i anashkalojnë edhe Kosovën, edhe Republikën e Shqipërisë. Pra, korridoret kanë vetëm linja të veçanta të Korridorit të linjës 10, edhe andej kah Tivari që diqysh të shkohet në Beograd, edhe ata Shqipërisë, edhe ne, ata kah Tivari, kah Mali i Zi, ne diqysh drejtpërdrejt për Leshak.

Prandaj, çështjen e Korridorit me Durrësin, që nuk është korridor i ri, është lidhje ndërmjet Korridorit 8 dhe Korridorit 10, që duhet ta bëjë këtë lidhje, që është vazhdim i tyre, duhet të hapet dhe të ngrihet dhe nuk ka deri tash, sa kam parë, dokumente të fizibilitetit, nuk ka asnjë dokument. Tregoni, se mua po më nevojiten. Po më nevojiten dokumentet e nënshkruara.

Sikur që mund ta gjesh dokumentin mes kryeministrit Kurti dhe kryeministrit Zaev për Prizren-Tetovë, po na nevojiten dokumente të nënshkruara në bazë të të cilave ne i bëjmë thirrje Republikës së Malit të Zi që ta vazhdojë rrugën prej kufirit deri në Plavë. Kjo po na nevojitet.

Po na nevojitet ai dokument i fizibilitetit, kush e ka bërë që e përmende për Rozhajë, se veç keni folur. Që keni folur po e dimë. Se për to, s'po e dimë as që keni folur. Por për atë që keni folur, po e dimë, së paku atë dokumentin e fizibilitetit, na trego se kush e ka nisur? Ku e presim atë rezultat, se kurrkund s'ka gjurmë të kësaj pune.

KRYETARI: Zoti Lekaj, një minutë!

PAL LEKAJ: Më vjen mirë që e pranoi që s'ka marrëveshje në Beograd. Përndryshe, në deklaratimet tuaja keni thënë që ka marrëveshje dhe jeni krenuar që ne s'po e lidhim Kosovën me Serbi, por me Durrësin, me Republikën e Shqipërisë.

Mirë që ju sfidova dhe opinioni publik tashmë e di që nuk ka marrëveshje të tillë. Dhe sa u përket komisioneve, dy komisioneve ndërshtetërore, janë të gjitha procesverbalet, në ministri i ke, në Departamentin e Rrugëve dhe në Departamentit për Zhvillim Strategjik të Infrastrukturës. Faleminderit!

KRYETARI: 60 sekonda, dhe përfundimtare, ministri Aliu.

MINISTRI LIBURN ALIU: I nderuar deputet,

Ato deklarime që po i thoni ju, keni deklaruar, kështu. Ato nuk qëndrojnë. Shumë qartë. Kam deklaruar në konferencë për media, ka pasur zotime të këtyre fushave. Tjetra, dallimin esencial, edhe një herë duhet ta përmendi, karshi Serbisë e kemi në atë që origjinën nuk e kemi në krijimin dhe lidhjen e korridorit që ndaras neve si shqiptarë na çojnë drejt Beogradit, por krijojmë lidhje ndërmjet nesh.

Pra, edhe ai fizibiliteti për të cilin folët, nuk ekziston. Edhe marrëveshja në Uashington flet më shumë, se flet për Adriatikun në përgjithësi, por në linjat reale, në linjat reale të terren e ke Tivar - Beograd, e ke Leshak - Beograd, ne lidhemi me të dyja. Ata në Shqipëri shkojnë prej Durrësit deri në Tivar, ne shkojmë prej aty.

Kjo ka qenë logjika, e cila e ka sjellë edhe Zajednicën, edhe ka sjellë pastaj Linjën 10 për ta shmangur veriun, e kështu me radhë.

Prandaj, dallimin mes nesh dhe jush...

KRYETARI: Fatmir Humolli e ka fjalën lidhur me këtë temë. Qetësi ju lutem, sepse deputeti Humolli e ka fjalën! A ka mundësi për veç pak qetësi, zoti Aliu!

FATMIR HUMOLLI: Unë s'kam dashur të dal e të flas pa i bërë Qeveria 200 ditë, për shkak se nja 20 vjet kanë udhëhequr me vendin partitë tjera politike, dhe së paku kam besuar që për 200 ditë Qeveria do të dëshmojë sesi do të funksionojë, më mirë ose më keq se ju.

Është e vërtetë që prej Kuvendit dhe prej Qeverisë kam kërkuar që të ndërtohet një institucion që do ta bëjë vlerësimin politik të rrethanave ndërkombëtare, të rrethanave tona, dhe si duhet të sillemi, apo si është dashur të silleshim konform gjendjes aktuale çfarë është që të kemi mundësi që ne si komb të përfitojmë sa më shumë.

Për mua pak me rëndësi është se qeveritarët tanë a diskutojnë në Beograd apo në Bruksel, a bisedojnë në Tiranë, ata janë qeveritarët tanë. Domethënë, është shumë më e rëndësishme se çka u thonë atje, por për mua, pikëpamja ime politike është se nga '92-ta deri në mars të '98-tës ka pasur inercion politik, dhe prej Rambujesë, prej marsit të '98-tës e deri në Rambuje ka qenë një politikë aktive që është zhvilluar.

Me Rambujenë ka filluar inercioni politik i shqiptarëve në raport me rrethanat ndërkombëtare, dhe këtu ka nevojë që të bëhet një analizë shkencore për të dhënë përfundime të sakta.

Liburni është ministër që e ka zgjedhur ky Kuvend! Për mua është ministër edhe unë e respektoj si ministër, ashtu sikur juve që ju respektoj...

(Nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Jo, se ky e ka me ju më shumë. Zoti Humolli, a dëshironi edhe pak kohë? 60 sekonda zotit Humolli që ta përfundojë.

FATMIR HUMOLLI: Edhe në fushatë kur kam dalë nuk i kam shfrytëzuar mediat që të marr vota, e kam shfrytëzuar rrethin shoqëror që të marr vota, se nuk ka qenë me çdo kusht që unë të hyj në këtë Kuvend.

KRYETARI: Pse e ke kërkuar fjalën, Abelard?! Ke folur nja 6-7 herë sot. Lidhur me çka dëshiron të flasësh? Ministrin Liburn Aliu, për hekurudhat a po? Urdhëro, e keni fjalën!

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Po e shfrytëzoj dhe po më pëlqen ky entuziazmi i madh që të flitet për infrastrukturë e për hekurudha të Qeverisë Kurti, por fatkeqësisht atë të që e pritëm sot të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, prindërit, nxënësit, që të flasë ministrja e Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor, nuk e pamë.

Të paktën e lëshoi edhe seancën dhe nuk dha kurrfarë shpjegimi se kur do të fillojnë shkollat. Kjo është e papranueshme nga kjo Qeveri, sepse në fillimin e këtij sesioni do të duhej që të paktën ministrja e Arsimit të na japë një sqarim të gjithë neve, qytetarëve të Kosovës, pse s'është bërë përgatitje e duhur, sikur i gjithë rajoni, që të fillojë edhe Republika e Kosovës.

Jemi i vetmi vend në rajon dhe në Evropë që s'i kemi hapur shkollat. Në anën tjetër, nuk dimë kurrgjë nëse fillon viti ri akademik më 1 tetor apo jo. Prandaj, mendoj që na duhet një sqarim nga kryeministri Kurti sa i përket kësaj çështjeje, sepse para asfaltit dhe infrastrukturës, besoj që ky është preokupimi më i madh i të gjithë qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Blerat Deliu e keni kërkuar fjalën, po ashtu. Le të jetë ky, po ashtu diskutimi i fundit dhe kalojmë në pyetjet parlamentare.

BLERTA DELIU: Faleminderit, kryetar!

Meqë u zgjat kaq shumë dhe u tejkalua edhe Rregullorja, unë e mora fjalën për një pjesë të diskutimeve që ishin sot, dhe po dalim konkretisht te gjuha parlamentare, zoti kryetar i Kuvendit, sepse u diskutua disa herë dhe jemi në fillim të Sesionit vjeshtor.

Kur e kemi parasysh faktin që jemi edhe në fushatë zgjedhore, unë jam e inkurajuar nga fjalimi i zotit Krasniqi, i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, për qasjen e tij bashkëpunuese që ai solli sot pikërisht në këto rrethana të rënda të pandemisë.

Por, dua të tërheq vërejtjen që duhet ta kuptoni që ne e përfaqësojmë opozitën dhe kur bëjmë opozitë, ne jemi mjaft të rafinuar në qasjen tonë në raport me të kaluarën dhe veprimet që ne i kemi parë bashkë me juve zoti kryetar i Kuvendit, në raport me sjelljet opozitare që ju i keni pasur, deri në gjuhën denigruese, fyese dhe ofenduese që e keni pasur në raport me opozitën.

Prandaj, në këto rrethana të rënda të përballjes me pandeminë, duhet që të jeni më racionalë në këtë qasje dhe ta kuptoni që kur flasim për bashkëpunim në të mirë të qytetarëve të vendit, nuk duhet ta goditni opozitën, siç po bën gjithmonë edhe zëvendëskryeministri Bislimi në komisione parlamentare, duke tentuar që t'i zhvlerësojë fjalimet e deputetëve edhe t'i ofendojë e t'i fyejë, ashtu siç edhe bëri sot me këtë qasje të tij arrogante, që më së paku i takon një zëvendëskryeministri të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Meqenëse jemi në përfundim të kësaj pike, ndoshta më shumë në interes të publikut që t'ia shpjegojmë se çfarë ndodhi sot.

Rregullorja e Kuvendit, që e dini ju, për këtë pikë parasheh 30 minuta, por e ka një pjesë tjetër kur thotë që pas këtyre 30 minutave fjalën e ka Qeveria dhe ministrat. E tash aty, ajo pjesa e Rregullores ku thotë fjalën e kanë ministrat, nuk kallëzon sa kohë.

Meqenëse kjo është e hapur në Rregullore, s'kallëzon sa kohë i kanë ministrat dhe Qeveria për diskutim, në kohën kur kryetare e Parlamentit ishte zonja Vjosa Osmani, me një vendim të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës u vendos që kjo pjesa kur flasin ministrat dhe Qeveria të jetë 30 minuta shtesë.

Ne i bëmë më shumë se një orë në këtë pikë, por kjo mund të bëhet vetëm nëse ka një konsensus ndërmjet Qeverisë dhe deputetëve të Parlamentit për t'i trajtuar temat në interes, në të mirën e publikut dhe në interes të të mirës së përgjithshme.

Por, unë po them që kjo do të jetë ndoshta hera e fundit që bëjmë kështu, sepse më mirë është që ta kemi një kohë të kufizuar, sepse në këtë mënyrë kjo pikë nuk mund të përfundojë kurrë, ose mund të paraqiten vazhdimisht deputetë të cilët nuk e kanë marrë fjalën në fillim, dhe kjo na paraqet me të vërtetë problem për funksionimin e Parlamentit të Kosovës.

Kjo le të jetë vërejtje edhe për ministrat, meqenëse tash kryeministri mund t'ua marrë juve 30 minuta të kohës dhe të flasë, sepse konsideron që është në të mirë t'i shpjegojë temat deri në fund. Kryhen 30 minuta, ua merr 30 minuta kryeministri, ministrat nuk kanë më punë aty çka. Mund të kthehen në ministri dhe të vazhdojnë punën e tyre.

Për tema tjera, mund të bëhen debate parlamentare, të trajtohen temat qysh i parasheh Rregullorja e Kuvendit, nëpërmjet interpelancave ose debateve parlamentare. Kështu që kjo le të jetë hera e fundit që e tejkalojmë këtë pikë të rendit të ditës kështu.

2. Pyetjet parlamentare

Deputeti Valon Ramadani e ka një pyetje për ministrin Fikrim Damka. Me siguri që është version turk i emrit Fitim. Pak humor. Valonin nuk e kemi këtu. Deputeti Bekim Haxhiu i ka bërë pyetjen ministrit Arben Vitia, ia ka parashtruar pyetjen. Kjo është pyetje është përsëritur nga hera e kaluar.

Po ashtu e ke një pyetje për ministrin Liburn Aliu, apo e ke të njëjtën që është përsëritur. Është përsëritur edhe kjo.

Atëherë kalojmë të pyetjet, të cilat bëhen për herë të parë. Deputeti Ramush Haradinaj e ka një pyetje për kryeministrin Albin Kurti.

RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit!

Për të mos e lexuar të gjithë analizën e pyetjes, pyetja ime për ju kryeministër ka të bëjë me projektin e përbashkët MCC - Qeveri e Kosovës, për investimin në tubacionin e gazit, pra

gazsjellësin dhe gazifikimin e Kosovës si burim alternativ i energjisë që do të sillte në Kosovë gazin amerikan.

Pra, në bazë të informatave që kemi dhe të raporteve që kemi lexuar, i bie që ju po i humbni afatet ose po i vononi, ndoshta edhe qëllimshëm, dhe po ju pyes pse ndodh kjo prej Qeverisë sonë, dhe a është kjo mënyrë të dështohet ky projekt, nëse vijmë të ndonjë projekt tjetër alternativ që e ceku presidenti i Serbisë, i cili paralajmëroi autostradën e paqes dhe gazsjellësin rus për Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri Kurti e ka fjalën për një përgjigje.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Faleminderit për pyetjen, deputeti Haradinaj!

Ne kemi punuar intensivisht dhe jemi në bashkëpunim të vazhdueshëm me korporatën e sfidave njëvjeçare të MSS sa i përket zhvillimit të programit të kompaktit si t'i referoheni.

Për këtë çështje gjatë pesë muajve të fundit i kemi zhvilluar pesë takime të nivelit të lartë, në të cilët kemi qenë bashkë me përfaqësuesit e lartë të MSS, ku ka qenë edhe pjesëmarrja ime, ose e ministrave relevantë, Rizvanolli, Murati dhe Hajdari.

Tutje Ministria e Ekonomisë, së bashku me kabinetin e saj dhe Departamentin e Energjisë në ministri dhe institucione të tjera relevante, si për shembull, KOST-i, KEK-u dhe ZRRE-ja, kanë vazhduar diskutimet dhe bashkëpunimin në nivel teknik. Në mbi 10 takime e punëtori të mbajtura gjatë kësaj periudhe me MSS-në kemi diskutuar në detaje për dizajnimin e projektit Kompakt, përmes të cilit do të përkrahej pjesërisht ndërtimi i infrastrukturës së gazit, por edhe për opsione të tjera, si investime në rrjetin e shpërndarjes, kapacitetet akumuluese dhe zhvillim të shkathtësive të fuqisë punëtore në sektor, sepse dihet që nuk i kemi.

Gjatë të gjitha këtyre takimeve ne kemi shtruar pyetje dhe kemi diskutuar analizën preliminare financiare të investimit, në veçanti qartësimin se cila do të ishte kosto totale. Çfarë pjese do të ishte grant, e sa do të duhej të marrim kredi si shtet. Kush do ta ndërtonte dhe operonte me termocentralin dhe me çfarë kushte dhe mbi të gjitha çfarë implikimi do të kishte prodhimi i energjisë elektrike nga gazi në tarifatat që do t'i paguanin qytetarët dhe bizneset, sepse atë energji do ta paguajë dikush në fund.

Vendime të tilla definojnë sektorin e energjisë për gjeneratat e ardhshme. Prandaj, ne jemi të përkushtuar t'i marrim dhe t'i analizojmë të gjitha të dhënat, informatat dhe opsionet, në mënyrë që të marrim vendime të mirë të informuara e të duhura, duke marrë parasysh përfitimet dhe kostot për taksapaguesit dhe për konsumatorët e energjisë.

Për neve kjo nuk është vonesë, kujt i duket vonesë, le ta kuptojë që është përgjegjësi dhe seriozitet. Nuk merren kuturu e shpejt e shpejt vendime kaq të mëdha.

KRYETARI: Zoti Haradinaj, siç duket e ka një pyetje shtesë lidhur me këtë temë.

RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryeministër,

Pyetja ime ka të bëjë edhe me afatet buxhetore të shumës që vjen nga korporata e mijëvjeçarit, a i rrezikojmë ato fonde, ta zëmë 200 milionë dollarë dhe a rrezikojmë më dinamikë, pra duke u kujdes ne për çmimin final që është serioze, a jemi në përputhje me afatet kohore për me e ruajt këtë mundësi investive, e cila me sa kam parë në raport, parasheh edhe një kredi të butë nga EBR-dia dhe nga totali i shumave të përdorura ose të parapara deri më tani nuk parashihet, pra nuk është cekur shuma që vjen nga institucionet e Kosovës, po kemi vetëm një burim që është grant, MSS 200 milionë dollarë, rreth 100 milionë kredi, e ju thatë një termocentral, me sa kuptoj unë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti kryeministër, për plotësimin e përgjigjes.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Më lejoni të sqaroj edhe nja dy çështje, të cilat po ashtu u ngritën.

Së pari duhet qartësuar se kur po flasim për ndërtim të infrastrukturës në bashkëpunim me MSS-në, nuk jemi duke folur thjesht për gaz amerikan, po thjesht për ndërtim të infrastrukturës.

Nëse do të ndërtonim një termocentral me gaz, operatorët do të blinin në treg të lirë gazin që mund të jetë amerikan, po s'është e thënë. Të gjithë këta faktorë të shumtë ne po i marrim parasys.

Gjithashtu duhet qartësuar se kjo nuk ka të bëjë me kërkesë të aktorëve amerikanë. MSS-si është organizatë amerikane, e cila është duke e përkrahur sektorin e energjisë në Kosovë dhe ne jemi falënderues për këtë gjë, jemi mirënjohës për gjithë bashkëpunimin e deritanishëm, është duke na afruar ndihmë më tej me projekte të ndryshme potenciale në këtë sektor, të cilët i përmenda më herët. Ne jemi falënderues për përkrahjen edhe bashkëpunimin e ngushtë që na kanë afruar gjatë këtyre muajve të qeverisjes për të vendosur se cilat projekte janë më të favorshme për konsumatorët, neve na duhet energjia e lirë për konsumatorët.

Duke mos harruar që edhe në një termocentral të ardhshëm me 200 megavatë, megjithatë përbën 1/5 të konsumit tonë. Pra nuk është që gazi ta zëvendësojë komplet qymyrin apo ta zgjidhë në planin afatgjatë problemin.

Ndërkaq një gjë e harrova, sa i përket ndërtimit të gazsjellësit përmes Serbisë, aty nuk ka asgjë të vërtetë. Ndërkaq fondet të cilat do të jenë, nuk do të rrezikohen, për shkak se ne jemi në komunikim të vazhdueshëm, të përditshëm me ta, nuk do të rrezikojmë asgjë, më shumë rrezikojmë nëse marrim vendim pa analiza e studim të mirëfilltë paraprak.

KRYETARI: Deputetja Arjeta Rexhepi i ka dy pyetje për ministrin Hajrullah Çeku, ministri i Kulturës. Ministri nuk është këtu.

ARJETA REXHEPI: Atëherë le të bartet për seancën tjetër.

KRYETARI: Mirë. Po ashtu deputeti Ardian Gola e ka tërhequr pyetjen e tij lidhur me arsimin që ia bën ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Sa deputetë i kemi të pranishëm në sallë aktualisht, në ndërkohë i thërrasim të tjerët që eventualisht ndodhen në bufe që të kthehen e të vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës.

Në ndërkohë, më lejoni të tërheq vërejtjen lidhur me deputetët që po e ndezin cigaren në hapësirat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse kemi ankesa nga shumë deputetë që tymi po hyn prej bufes në sallën e Kuvendit. Ju tregojmë edhe një herë që duhani është shumë i dëmshëm për shëndetin. I ndaluar po se po, po edhe dëmton shëndetin.

61 deputetë i kemi të pranishëm në sallë.

A keni vërejtje ju pyes për procesverbalet e seancave, të cilat i kemi mbajtur më 2, 3, 6 dhe 12 gusht. Nëse nuk keni vërejtje në procesverbale, konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave të përmendura.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Legjislacion, në bazë të nenit 56 të Rregullores e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Me këtë rast, e ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Albulena Haxhiu, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Më lejoni që të paraqes para jush Projektligjin për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Çështja e të drejtave pronësore për shtetasit e huaj nuk është e rregulluar deri më tani me ndonjë akt ligjor. Edhe përkundër faktit se në nenin 121, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet se llojet e pronës rregullohen me ligj dhe se personat fizikë të huaj mund të sigurojnë të drejtat e pronësisë mbi pronën e paluajtshme në pajtim me kushtet e arsyeshme, të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare.

Pra, pavarësisht që kjo parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, deri tani nuk kemi pasur një ligj që do të rregullonte të drejtën e pronësisë për persona të huaj në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i të drejtave pronësore të personave të huaj fizikë dhe juridikë, duke përfshirë krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen, kufizimin ose marrjen në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me ligje përkatëse të pronësisë apo të drejtave të tjera sendore që mund të krijohen sipas ligjit.

Sipas projektligjit që keni para vetes, personat e huaj fizikë dhe juridikë mund të jenë titullarë të të drejtave pronësore sipas parimit të reciprocitetit.

Kjo nënkupton që, nëse një shtetas i huaj ka interes të ketë pronë në Republikën e Kosovës, atëherë ai mund ta ketë këtë në qoftë se shtetasi i Kosovës ka të drejtën e pronësisë në vendin prej nga vjen shtetasi i huaj.

Pra, për shembull, nëse një shtetas i Britanisë dëshiron të jetë pronar i pasurisë së paluajtshme në Kosovë, atëherë kjo bëhet e mundur nëse Britania u mundëson shtetasve të Republikës së Kosovës të jenë pronarë të pronave të paluajtshme atje.

Projektligji që keni para vetes po ashtu parasheh edhe kufizime në të drejtat pronësore dhe atë kur bëhet fjalë për pasuritë natyrore, të mirat publike në përdorim të përgjithshëm, tokat bujqësore në pronësi publike, pyje dhe toka pyjore në pronësi publike, pronat publike të luajtshme apo të paluajtshme të shpallura trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë, paluajtshmëria, e cila gjendet brenda një kilometri nga kufiri, paluajtshmëria, e cila gjendet në zonën, e cila paraqet mbrojtje të interesit dhe sigurisë së shtetit dhe me ligj të veçantë shpallet se personi i huaj nuk do të ketë të drejtën e pronësisë, në paluajtshmëri në pronësi publike, të cilat sipas ligjeve në fuqi nuk mund të kalojnë në pronësi private as të shtetasve të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Me miratimin e këtij projektligji Republika e Kosovës bën një hap të rëndësishëm në drejtim të përmbushjes së obligimeve që kemi si shtet në raport me Bashkimin Evropian, obligime këto të përcaktuara edhe me Marrëveshjen për Stabilizim Asociim. Në nenin 65.3 të kësaj marrëveshjeje thuhet që Kosova duhet t'u ofrojë shtetasve të BE-së tretman si vendasve në sigurimin e të drejtave pronësore mbi pronën e paluajtshme.

Bazuar në rëndësinë, nevojën dhe domosdoshmërinë për rregullimin e aspekteve pronësore të shtetasve të huaj, ju ftoj për miratim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti Adnan Rrustemi, që ta arsyetojë këtë projektligj.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26.07. e shqyrtoi Projektligjin numër 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji numër 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare, në pajtim me nenin 58, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit e shqyrtoi në parim projektligjin e theksuar dhe konstatoi se i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim.

Për këtë arsye i rekomandon Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin në pajtim me rregullat e Rregullores së Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Tash, radha e grupeve parlamentare. Nga Lëvizja Vetëvendosje, sërish Adnan Rrustemi.

ADMAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i të drejtave pronësore të personave të huaj fizikë dhe juridikë, duke përfshirë krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen, kufizimin ose marrjen në pajtim me kushtet dhe procedurën e përcaktuar me ligjet përkatëse si dhe shuarjen e të drejtave pronësore të shtetasve të huaj në pronësi apo në të drejta të tjera sendore që mund të krijohen sipas ligjit.

Projektligji gjithashtu trajton çështjen e fitimit të së drejtës pronësore nga shtetasit e huaj, çështjen e reciprocitetit, reciprociteti në fitimin e të drejtave pronësore të një vendi të huaj në pronën e paluajtshme, të drejtat pronësore të personave shtetas të shteteve anëtare të BE-së, kufizimin e të drejtave pronësore në pronën e paluajtshme për persona të huaj, e të tjerë.

Në praktikë shtetasit e huaj kanë pasur probleme në lidhje me çështjen e të drejtës pronësore në Kosovë.

Ky projektligj synon të bëjë të qartë këtë të drejtë, e që kjo pritet të ndikojë edhe në inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë dhe të ndikojë që Kosova të integrohet edhe më shumë në ekonominë globale.

Po ashtu ky projektligj përcakton edhe kufizimet që kur personi i huaj nuk ka të drejtën e pronës te pronat publike të përcaktuara me Ligjin për prona publike dhe aty si pasuri natyrore, të mira publike në përdorim të përgjithshëm, toka bujqësore në pronësi publike, pyje dhe toka pyjore në pronësi publike, prona publike të luajtshme apo të paluajtshme të shpallura trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë, paluajtshmëria, e cila gjendet brenda një kilometri nga kufiri, paluajtshmëria, e cila gjendet në zonën e cila paraqet mbrojtjen e interesit dhe sigurisë së shtetit dhe me ligj të veçantë shpallet se personi i huaj nuk ka të drejtën e pronësisë dhe paluajtshmëritë në pronësi publike, të cilat sipas ligjeve në fuqi, nuk mund të kalojnë në pronësi private as të shtetasve të Kosovës.

Megjithatë, përjashtim nga këto kufizime bëhet kur personi i huaj fizik mund të fitojë të drejtën e pronësisë mbi pasuritë bujqësore, pyjore dhe toka pyjore një sipërfaqe deri në 5000 metra katrorë, vetëm në qoftë se objekti i marrëveshjes përfshin ndërtesë banimi vendos në atë vend apo me qira afatgjate, koncesion dhe marrëveshje tjetër mbi paluajtshmëritë.

Me këtë projektligj shënohet eliminimi i të gjitha mangësive, zbrazësive dhe vështirësive të evidentuara nga ana e institucioneve përgjegjëse në këtë fushë. Andaj, bazuar në këto, ne si grup parlamentar e mbështesim miratimin e këtij projektligji në lexim të parë. Natyrisht në mes të dy leximeve deputetët mund të japin kontributin e tyre për ta përmirësuar apo amendamentuar. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Partia Demokratike, fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj po ashtu është njëri ndër shumë projektligjet të cilat kjo Qeveri i ka gjetur të gatshme dhe kemi të paqartë pse një projektligj i gatshëm është vonuar më shumë se gjashtë muaj, e shohim si draft që është punuar në vitin 2018-2019.

Sido qoftë, siç e dini ky projektligj është rezultat i strategjisë kombëtare për të drejtat e pronës dhe njëkohësisht përmbush edhe një obligim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës.

Krijimi i bazës ligjore, e cila rregullon çështjen e fitimit të së drejtës pronësore nga shtetasit e huaj është i rëndësishëm dhe konfirmon seriozitetin e shtetit të Kosovës në trajtimin reciprok të shtetasve të huaj.

Konsideroj se brenda këtij projektligji ka hapësirë për të qartësuar më mirë të drejtat pronësore të shtetasve të huaj, të atyre të BE-së, në veçanti, përfshirë kushtet u kufizimit të këtyre të drejtave, pastaj vlerësimin e trajtimit të reciprocitetit dhe rolin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Megjithatë, ne si Grup Parlamentar, në këtë rast, përmes përfaqësuesve në komision për legjislacion e kemi përkrahur në lexim të parë dhe sot do ta votojmë në lexim të parë, kurse kontributin tonë do ta japim në mes të dy leximeve. I ftoj kolegët deputetë që sot ta votojnë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën nga LDK-ja e ka deputeti Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës dhe normalisht vlerësimi ynë është pozitiv për këtë iniciativë, për këtë projektligj. Kam thënë edhe atë ditë në prezantim në grupin parlamentar që e ka pasur zëvendësministri i Drejtësisë, po edhe sot ministrja e Drejtësisë që deklarimi i tyre është që ky projektligj është si derivat i kërkesës së MSA-së, Marrëveshjes së MSA-së, shumë pozitive kjo.

Por, po dua t'jua rikujtoj juve dhe njerëzve që po na shikojnë që Lëvizja Vetëvendosje nuk i ka dhënë mbështetje, nuk e ka votuar MSA-në, kur po i sillni projektligjet, referencë e keni MSA-në. Unë jua njoh të drejtën e transformimit, jua njoh të drejtën e ndryshimit, po duhet ta evidentojmë që njerëzit ta kuptojnë, që dokumentet që ju nuk i keni votuar, sot po i merrni referencë dhe po na i sillni këtu. Normalisht që kjo MSA është votuar dhe është ratifikuar në kohën e Qeverisë nga LDK-ja, në kohën e Qeverisë të zotit Mustafa.

Ky projektligj i ka, në fakt, 5-6 nene në kuptimin substancial, 2-3 janë krejt kështu rutinë. Disa çështje unë mendoj që mund të shtohen këtu, në mënyrë që të mos e lëmë që këto çështje të rregullohen me udhëzime administrative ose me legjislacionin sekondar, po këtë kontribut do ta japim nga leximi i parë në leximin e dytë gjatë asaj periudhe, në mënyrë që kjo e drejtë kushtetuese, e garantuar me Kushtetutën e Kosovës, të jetë e realizueshme edhe për shtetasit tonë, të cilët jetojnë diku tjetër. Ky projektligj i jep rëndësi të madhe parimit të reciprocitetit dhe si i tillë duhet vlerësuar dhe duhet mbështetur. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Gazmend Gjyshinca, nga Lëvizja Vetëvendosje.

GAZMEND GJYSHINCA: Kemi problem me mikrofon.

KRYETARI: Ia lëshoni fjalën deputetit, ju lutem. Mund të flisni nga mikrofoni tjetër, të lutem, Gazmend. Ose që nuk përton zonja Pacolli, ndërroni vendet që të mund të flisni.

GAZMEND GJYSHINCA: Të nderuar qytetarë,
Para vetes për shqyrtim kemi një ligj të rëndësishëm, të cilin duhet trajtuar me seriozitetin e merituar, sidomos për efektet që mund t'i prodhojë pas miratimit të tij.

Sot po e shqyrtojmë për herë të parë Projektligjin nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës. Në veçanti ky ligj duhet trajtuar nga perspektiva e lirive dhe të drejtave të njeriut, perspektiva e sigurisë nacionale dhe sidomos në dritën e luftës ndaj shpëlarjes së parasë në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Prandaj, në rend të parë në lidhje me çështjen e fitimit të pasurisë së paluajtshme në Kosovë duhet pasur parasysh dy gjëra: kjo fushë nuk është e rregulluar me të drejtën e Bashkimit Evropian, pra është fushë që secili shtet e rregullon sipas nevojave të veta dhe 2. Çështja e fitimit të së drejtës së vendbanimit apo e drejtës së qëndrimit pas fitimit të pronësisë mbi pasuri të paluajtshme.

Sa u përket shtetasve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të njëjtit brenda BE-së janë të barabartë dhe mund të blejnë pasuri të paluajtshme pa ndonjë problem, duke marrë parasysh që është në pajtim me lirinë e lëvizjes, njëra ndër katër liritë themelore të Bashkimit Evropian. Ndërkaq, restriksione të ndryshme zbatohen ndaj shtetasve të shteteve të treta, pra jo të Bashkimit Evropian, ndaj të cilëve zbatohen disa masa kufizuese, të cilat do t'i elaboroj më

poshtë. Por, kur ne flasim për këtë projektligj, janë disa vërejtje që kam evidentuar, e që konsideroj se është e rëndësishme të përmenden.

1. Sa i përket të drejtës së fitimit të pronësisë nga shtetasit e shteteve anëtare, e njëjta paraqet një problem të caktuar. Ligji parasheh që qytetarët e vendeve të Bashkimit Evropian mund të blejnë pronë në Kosovë, sikur që mund të blejnë në vendet e tjera, mirëpo diçka e tillë nuk është përcaktuar në legjislacionet e vendeve të tjera, të cilat këtë të drejtë nuk e parashohin për qytetarët e Republikës sonë. Për shembull, një shtetas gjerman mund të blejë pronë në Kosovë po ashtu, edhe një qytetar i Kosovës mund të blejë pronë në Gjermani, por që me këtë nuk e fiton të drejtën e vendqëndrimit.

Një gjë e tillë duhet të përcaktohet edhe me ligjin tonë, pra që shprehimisht të ceket se me fitimin e pronësisë mbi një send të paluajtshëm brenda Republikës sonë, nuk fitohet automatikisht e drejta e qëndrimit në Kosovë apo shtetësi, për shkak se kjo rregullohet me ligje të tjera.

2. Po ashtu, në rastin konkret, qytetarët tanë diskriminohen nga shtetet e Bashkimit Evropian, sepse me shumicën nuk kemi marrëveshje bilaterale dhe rrjedhimisht ata mund të blejnë pronë në Kosovë, përderisa shtetet anëtare të BE-së parashohin më pak të drejta për qytetarët e Kosovës. Ta zëmë, për shembull, Austria e kufizon këtë të drejtë me një interes publik, gjegjësisht ekonomik dhe fitimit të pronësisë i paraprin një vendim administrativ i shtetit austriak që konstaton interesin e shtetit austriak kundruall blerjes së pronës nga një shtetas kosovar.

Si vërejtje tjetër është vërejtja, apo thënë më mirë, pyetja se çka ky ligj i prezantuar, të cilin po e shqyrtojmë për herë të parë sot, nënkupton me konceptin “të huajt”. Pra, ligji ynë bën vetëm një përkrahje të shkurtër të asaj se çfarë vlerësohet personi juridik i huaj, ndërsa ta zëmë disa shtete të Bashkimit Evropian personin juridik të huaj e vlerësojnë me këto kategori: a. si persona fizikë që nuk kanë nënshtetësi të vendit, b. personat juridikë që selinë e tyre apo administrimin kryesor, pra selia kryesore gjendet në një vend të huaj, c. personat juridikë që janë themeluar brenda shteteve në fjalë, por që shumica e aksioneve të atij themelimi mbahen nga personat me nënshtetësi të huaj, OJQ ose fondacione, përfitimet e të cilave kryesisht shkojnë për personat, të cilët jetojnë jashtë vendit.

Të nderuar deputetë, anëtarë të këtij kuvendimi, kushtëzimi i blerjes sipas legjislacionit të vendeve të ndryshme ndërtohet mbi metodologji të ndryshme. E kam të qartë, mirëpo blerja e një prone të huaj nga shtetas të huaj kufizohet me disa kushte pa përjashtim. Kështu, për shembull, disa vende anëtare të Bashkimit Evropian blerjen e një prone e kufizojnë me plotësimin e këtyre kushteve: 1. Është interesi kulturor, pra ato raste kur shtetasi i huaj dëshiron që përmes blerjes të zhvillojë aktivitete kulturore brenda atij vendi. 2. Interesi social, në rastet kur blerësi i huaj përmes pronës dëshiron të plotësojë nevojat e tij personale për banim, 3. Interesi ekonomik ekziston atëherë kur objekti i blerjes i shërben qëllimit të krijimit ose zgjerimit të një biznesi

ekzistues apo të ri që pritet të krijohet dhe, e fundit që është më i rëndësishmi është 4. Interesi politik shtetëror. Ky është kriter bazik që merret parasysh në të gjitha blerjet. Institucionet shtetërore kontrollojnë nëse blerja shkel ndonjë interes shtetëror, në veçanti policia dhe nëse është e nevojshme ushtria.

Po ashtu, për ta përmbyllur trajtimin e këtij projektligji në shqyrtim të parë, në rastin tonë duhet pasur parasysh edhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Kur flitet për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj, shumica e vendeve kërkojnë një miratim paraprak nga institucionet përkatëse, ku përveç plotësimit të kushteve të përgjithshme për fitimin e pronësisë, kërkohet edhe miratim i organit administrativ, i cili shikon se a janë plotësuar kushtet në fjalë, të cilat i përmenda edhe më lart. Si shembull i fundit për ta kuptimësuar këtë rezymë të shqyrtimit të parë të projektligjit në fjalë është Zelanda e Re. Pra, mund të na shërbejë si shembull.

Fillimisht, në Zelandë kanë mundur të blejnë prona të gjithë personat. Me këtë rast shumë shtetas kinezë kanë blerë banesa në kryeqytetin e Zelandës së Re, me ç'rast çmimet e patundshmërisë janë rritur aq shumë sa që qeveria është detyruar që pastaj të nxjerrë një ligj që blerjen e pronësisë së paluajtshme e ka lidhur me posedimin e një leje qëndrimi afatgjatë lëshuar nga Zelanda e Re. Mirëpo, në rastin tonë duhet pasur parasysh që çështjet e tilla mund të zbatohen vetëm ndaj shteteve joanëtare të Bashkimit Evropian, sepse Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, në nenin 51 të saj, parasheh kushte jo më pak favorizuese për personat dhe kompanitë që vijnë nga Bashkimi Evropian. Për ta përmendur, për fund, është shumë e rëndësishme që këtë projektligj ta shohim në perspektivën e lirive dhe të drejtave të njeriut, në perspektivën e luftës ndaj shpëlarjes së parave në nivel vendi dhe ndërkombëtar. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Tash, ministre, a e do fjalën? Ministrja Haxhiu e ka fjalën.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit edhe një herë, kryetar i Kuvendit!
Lidhur me çështjet që u ngritën nga deputetët, më lejoni që t'i adresoj disa çështje.

Së pari, nga përfaqësuesi i PDK-së, zoti Beqa, anëtar i Komisionit për Legjislacion, tha që pse e keni vonuar këtë projektligj aq gjatë, e keni gjetur të gatshëm, e të tjera, e të tjera. Më lejoni që të paktën për deputetët e Kuvendit, por edhe për qytetarët e Kosovës t'ju njoftoj që në Ministrinë e Drejtësisë në momentin kur kam pranuar detyrën, kam gjetur nëntë projektligje pothuajse të gatshme. Në gjashtë prej tyre kemi formuar grupet punuese për ndryshime substanciale. Ndërsa, në tri prej tyre jo, për faktin se e kemi konsideruar që nuk ka nevojë që t'i rihapim grupet punuese dhe të bëjmë ndonjë ndryshim substancial. Pra, së pari është dashur ta bëjmë një vlerësim të gjendjes, e pastaj t'i procedojmë me radhë projektligjet, për të cilat nuk kemi vërejtje. Pra, vetëm në tri prej tyre nuk kemi pasur vërejtje, prandaj edhe i kemi proceduar.

Sa i përket çështjes së zotit Selmanaj, që tha se ju e keni kundërshtuar Marrëveshjen për Stabilizim-Asociimi, më lejoni t'ju njoftoj që ne e kemi kundërshtuar fusnotën në këtë Marrëveshje dhe jo Marrëveshjen si të tillë. Prandaj, obligimet që dalin nga kjo marrëveshje qeveria jonë do t'i zbatojë si të tilla. Po ashtu, sa i përket çështjes apo propozimeve që i adresoi deputeti Gjyshinca, disa prej tyre mund të adaptohen në këtë projektligj, por disa të tjera jo, për faktin se është standard edhe në vendet e tjera një projektligj i tillë. Më lejoni t'ju njoftoj që shtetasit e Republikës së Kosovës kanë të drejtën që të jenë titullarë të pronave të paluajtshme në Gjermani, domethënë Gjermania e aplikon dhe mundëson këtë gjë. Ka edhe shumë vende të Bashkimit Evropian që aplikojnë të njëjtën, megjithatë unë konsideroj që janë disa vërejtje të tjera, të cilat mund të adaptohen lehtë. Prandaj, në këtë drejtim jo vetëm juve, por edhe të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të cilët kanë vërejtje të tjera, le t'i dërgojnë amendamentet e tyre brenda afatit dy javë, siç e dini dhe natyrisht ne si Ministri e Drejtësisë i mirëpresim dhe do të bashkëpunojmë bashkë me ju. Faleminderit!

KRYETARI: Njoftoni, ju lutem, urdhëroni, zoti Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Ministre, unë thashë që e kam marrë draftin që ka qenë më 2019 dhe draftin që kemi kaluar në komision, nuk kam parë ndonjë ndryshim dhe kjo ishte arsyeja që dhashë, ndoshta nuk ka pasur arsye të vonohemi, këtë e konfirmuat edhe ju që realisht edhe në kohën e qeverisjes së PDK-së janë bërë punë të mira, nuk po sjell ndonjë ndryshim ti diçka tjetër, edhe pse në atë kohë keni bërë zhurmë. Kurse, sa i përket këtij ligji, unë nuk kam parë asnjë ndryshim, nëse ke bërë një ndryshim prej asaj që ka qenë më 2019, mund ta thuash te kjo ndryshimet substanciale që i thatë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministrja për të shpjeguar ndryshimet substanciale.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: S'po di, bre, deputeti Beqa, sa herë po flas, po më duket që s'po më dëgjon. Edhe herëve të tjera kur kam qenë në këtë seancë, kur më keni bërë pyetje, t'u kam përgjigjur, po më duket se s'po më dëgjon. Në qoftë se bën pyetje, duhet mbajtur përgjigjen, prandaj të ftoj që ta bësh një gjë të tillë.

Unë thashë që në tri prej projektligjeve që i kemi gjetur në Ministrinë e Drejtësisë nuk kemi bërë asnjë ndryshim, për ligjin konkret nuk kemi bërë asnjë ndryshim. Pra, është ky, është ligji që vjen në radhë, është Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar. Pra, në këto tri projektligje nuk kemi bërë asnjë ndryshim, sepse jemi pajtuar me përmbajtjen, prandaj edhe nuk kemi bërë ndryshime të tilla. Unë kështu e thashë, por zakonisht ti po i keqinterpretton deklaratat e mija, prandaj edhe po e sqaroj.

KRYETARI: Ta marrim numrin e deputetëve sa janë në sallë. 75 deputetë i kemi të pranishëm, kështu që mund të hyjmë në procedurën e votimit të këtij ligji.

Deputetë të nderuar, ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni për Projektligjin 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Konstatoj që me 77 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin, të cilin e parasheh Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin këtë projektligj bashkë me rekomandimet.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit

Të nderuar deputetë, Komisioni Funkcional për Legjislacion, në bazë të nenit 56 të Rregullores e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar atë që ta miratojë.

E ftoj sërish ministren e Drejtësisë, zonjën Albulena Haxhiu, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj para Kuvendit.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të paraqes para jush për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për parandalimin e korrupsionit.

Qëllimi i këtij projektligji është qartësimi i fushëveprimit të Agjencisë aktuale Kundër Korrupsionit, si organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin e korrupsionit, po ashtu me të njëjtin qartësohet autoriteti i Agjencisë për parandalimin e korrupsionit për shqiptimin e masave dhe sanksioneve në përputhje me këtë ligj. Përveç mandatit parandalues të Agjencisë, po ashtu me anë të këtij projektligji rregullohen procedurat lidhur me zbatimin e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Ligji për deklarimin e pasurisë dhe prejardhjen, kontrollin dhe atë të

dhuratave, të cilin jemi duke i bërë ndryshime substanciale dhe pastaj pasi t'i kemi të finalizuara ato, do ta procedojmë në Kuvendin e Kosovës, si dhe Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Përmes projektligjit që e keni para vetes, Agjencia për parandalimin e korrupsionit po ashtu do të ketë në mandat të tij vlerësimin kundër korrupsion të akteve ligjore, me qëllim të zbulimit dhe minimizimit të rreziqeve të hapësirave për korrupsion në legjislacion, përkitazi me këtë Agjencia për parandalimin e korrupsionit do të ketë mundësinë e dhënies së rekomandimeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës apo për Qeverinë mbi vlerësimin e projektligjeve që lidhen me parandalimin e korrupsionit. Po ashtu, me këtë projektligj parashihet fuqizimi i kriterëve për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Në këtë drejtim, më lejoni t'ju njoftoj që në dispozitat përfundimtare të tij theksohet që zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për parandalimin e korrupsionit bëhet sipas këtij ligji. Andaj, unë jam e informuar që tashmë kanë kandiduar për këtë pozicion shumë kandidatë, por meqë ky projektligj thotë që drejtori i Agjencisë për parandalimin e korrupsionit zgjidhet sipas këtij ligji, ju inkurajoj që ta vlerësoni në Komisionin për Legjislacion se cilët janë hapat që do t'i ndiqni, për faktin se ky projektligj fuqizon kriteret për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për parandalimin e korrupsionit, prandaj besoj që Komisioni për Legjislacion do të duhej të vendoste në raport me këtë.

Më tutje, ky projektligj parasheh që mandatin për ta hartuar strategjinë kundër korrupsionit do ta ketë qeveria dhe jo Agjencia Kundër Korrupsion, siç e ka aktualisht dhe kjo është natyrisht e rëndësishme, pasi që Qeveria e harton atë në përputhje me politikat qeveritare në luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Prandaj, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ne do të nisim punën në hartimin e strategjisë kundër korrupsionit.

Një problem me të cilin është ballafaquar Agjencia Kundër Korrupsionit kanë qenë mosinformacionet lidhur me lëndët që ka deponuar në prokurori. Kjo është munduar të adresohet nëpërmes nenit 18, ku Prokuroria është e obliguar ta njoftojë agjencinë në rast të hedhjes së kallëzimit penal apo ndonjë ndjekje të pasuksesshme. Gjithashtu, me anë të këtij projektligji agjencia ka kompetenca për të shqiptuar sanksionet kundër personave fizikë dhe juridikë, si dhe institucioneve në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, për deklarimin e pasurive dhe të ardhurave, gjoba mund të bëjë, qortim jopublik, qortim publik, publikimin e opinionëve dhe të tjera. Bazuar në rëndësinë dhe nevojën për avancimin e mëtutjeshëm të legjislacionit dhe me qëllim të fuqizimit të agjencisë, unë ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj. Në fund fare, më lejoni t'ju njoftoj që me gjithë këto kompetenca parandaluese që ka Agjencia për parandalimin kur të hyjë në fuqi, tani ky ligj ka nevojë për kapacitete shtesë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, pa dyshim ato të cilat janë të rëndësishme ne do t'i aprovojmë, në mënyrë që Agjencia për parandalimin e korrupsionit ta kryejë punën sipas Kushtetutës dhe sipas legjislacionit në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Tash është radha e grupeve parlamentare.

Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, zoti Adnan Rrustemi, kryetar i këtij komisioni, për ta arsyetuar raportin.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik e shqyrtoi Projektligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare, në pajtim me nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit e shqyrtoi në parim projektligjin e theksuar dhe konstatoi se i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim e miratim në parim. Për këtë arsye i rekomandojmë Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin në lexim të parë në përputhje me rregullat e Rregullores së Kuvendit të Republikës. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lëvizja Vetëvendosje, sërisht Adnan e ke kërkuar fjalën, tash në emër të grupit parlamentar, Adnan Rrustemi.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderur kolegë deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji është qartësimi i fushëveprimit të agjencisë në fushën e parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve dhe administrative në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit, procesit të deklarimit të pasurisë dhe dhuratave, si dhe çështjeve që ndërlidhen me sinjalizuesit.

Projektligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit e përcakton funksionimin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit si organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin e korrupsionit që bie brenda fushëveprimit të saj. Me këtë adresohet në thelb ndryshimi i statutit të Agjencisë, qartësimi i përgjegjësive të Agjencisë Kundër Korrupsionit, kompetencat e Agjencisë, kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë, ndryshimi nga hetimet paraprake në hetime administrative dhe përcaktimi i masave

dhe sanksioneve, rregullimi i çështjeve të hartimit dhe monitorimi i planeve të integritetit, si dhe vlerësimi kundër korrupsionit dhe i akteve të tjera ligjore.

Çështjet e trajtuara në këtë projektligj konsistojnë në nevojën e ndryshimit të Ligjit në fuqi për shkak të pengesave që kanë lindur gjatë zbatimit dhe atyre çështjeve që nuk kanë qenë të mbuluara me dispozita përkatëse ligjore.

Risi e këtij projektligji janë edhe hetimet administrative dhe procedurat deri te përfundimi i hetimeve administrative, duke paraparë edhe masa ndëshkuese, si dhe përcjellje të rasteve në Prokurori dhe organe administrative përkatëse, në mënyrë që të ndërmerren masa adekuate sipas natyrës së shkeljes. Gjithashtu, siç e tha edhe ministrja e Drejtësisë, janë fuqizuar edhe kriteret për drejtorin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, ku nga pesë vjet sa është aktualisht, në projektligj është ndryshuar në tetë vjet përvojë pune, nuk duhet të ketë aktakuzë për krime, pezullimi nga detyra në rast të ngritjes së aktakuzës, kandidati të mos ketë qenë pjesë e ndonjë subjekti politik në gjashtë vjetët e fundit, si dhe mënyrën e votimit apo të zgjedhjes në Kuvend nga i mbyllur në votim, përkatësisht zgjedhje të hapur.

Ne e mbështetim si Grup Parlamentar këtë projektligj dhe natyrisht ndërmjet dy leximeve, deputetët janë të lirë dhe mund të japin kontributin me përmirësime dhe amendamente. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nga PDK-ja, fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Republika e Kosovës gjatë dy dekadave të fundit e ka kaluar një periudhë të ngjeshur të tranzicionit që bashkë me partnerët tanë si shtet, madje edhe si shoqëri kemi bërë përpjekje që t'i vendosim rregullat e duhura në këtë demokracinë tonë të re. Natyrisht është dashur që të përshtatemi në shumë aspekte, është dashur të vendosim dhe të plotësojmë standarde dhe është dashur të jemi edhe vetëkritikë rreth asaj se ku duam të arrijmë dhe ku jemi realisht si shtet. Veçmas në këto vite të shtetësisë, këto 13 vjet, besoj se na kanë bërë të gjithëve të qartë se shoqëria e Kosovës është shoqëri bashkëkohore, e emancipuar, e gatshme për të ecur tutje në agjendën tonë evropiane dhe se përgjegjësia për ta bërë këtë, përveç që është përgjegjësi e jona kolektive, kryesisht bie mbi sferën institucionale dhe mbi atë politike.

Unë sot nuk dua t'u bëj krahasime se çfarë kemi bërë ne sa ishim në pushtet në fushën e sundimit të ligjit, e çfarë po bën tashmë kjo Qeveri, sepse edhe krahasimi ndoshta do të duhej të ishte i pasaktë për shkak të kohës joproportionale të qeverisjes. Megjithatë, përjashtoj këta gjashtë muaj të Qeverisë Kurti në vitin e kaluar, kur në fakt nuk është bërë asgjë, kjo Qeveri tashmë i ka bërë

edhe gjashtë muaj të tjerë dhe besoj se janë të mjaftueshëm për të kuptuar dhe për të saktësuar se e ka apo nuk e ka kjo Qeveri një agjendë të qartë në fushën e sundimit të ligjit.

Derisa sot po e shqyrtojmë në lexim të parë Projektligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, të mos harrojmë se, ashtu siç e tha edhe paraprakisht kolegu im Beqa, edhe ky projektligj është njëri ndër shumë projektligjet të cilat janë nisur dhe janë bërë në Qeverinë e Partisë Demokratike të Kosovës, por, për fat të keq, kjo Qeveri, jo vetëm që nuk e ka rishikuar të drejtën të cilën natyrisht e ka pasur nëse nuk është pajtuar me ato politika e propozime, por as edhe një shkronjë nuk e ka ndryshuar nga to.

Projektligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit është akt i rëndësishëm ligjor nëpërmjet të cilit do të ripërcaktohet siç u tha roli i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, do të rriten kompetencat e Agjencisë, do të ndryshojnë kriteret për përzgjedhjen e kryeshefit të Agjencisë dhe do të zgjerohet mandati i tij deri në nivel të rritjes së integritetit të institucioneve, si të nivelit qendror, ashtu edhe të atij lokal. Po ashtu, do të ketë edhe të drejtën, siç u tha, të hetimeve. Po e theksoj se e kemi mbështetur edhe në Komisionin Parlamentar si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe projektligji është filluar nga ish-ministri Tahiri, si pjesë e pakos ligjore anti-korrupsion. Por, në fazën e finalizimit ka ndodhur tranzicioni i Qeverisë. Në Qeverinë paraprake, dua të kujtoj se ministri Selimi e ka finalizuar pas konsultimeve publike, të cilat janë mbajtur në dhjetor të vitit 2020, e sot kjo Qeveri e ka sjellë të njëjtin projektligj. Është mirë që ministrja e ka sjellë të njëjtin projektligj. Por, nëse e ka sjellë të njëjtin, pse atëherë është dashur që të vonohet gjashtë muaj? Pse është dashur të vonohet kaq muaj një projektligj kaq i rëndësishëm, siç u tha sot, të cilin ministrja e ka gjetur në sirtar?

Kolegë deputetë,

Unë nuk dua të paragjykoj, por kemi folur shumë për parandalimin e luftimin e korrupsionit e sot, jo që nuk keni asnjë vizion e ide tuajën origjinale, por edhe ato projekte që i keni gjetur të gatshme i vononi në mënyrë të pashpjegueshme, zonja ministre. Ky është një projektligj i rëndësishëm për ngritjen e integritetit të institucioneve tona, prandaj ne e mbështetim pa asnjë rezervë në shqyrtim të parë. Jo pse është produkti i nismave tona dhe se duhet të mbështetet, por se nëpërmjet tij adresohen çështje shumë serioze të mandatit të Agjencisë që ndihmojnë në rrugëtimin e zhvillimit të agjendës sonë integruese.

Sigurisht që janë disa çështje që meritojnë vëmendje e debat të shtuar, të cilat ne do t'i trajtojmë brenda dy leximeve në Komisionin Parlamentar. Mendoj se reflektimi ynë i përbashkët duhet të ketë pikëpreket mbi atë se ky projektligj a po u përgjigjet në të vërtetë nevojave të kohës për parandalim dhe luftim të korrupsionit dhe i adreson kërkesat për procesin e liberalizimit të vizave dhe a e forcojnë perspektivën evropiane të Republikës së Kosovës. Pra, edhe nëpërmjet këtij projektligji, fuqizimin e sundimit të ligjit duhet parë në tri perspektiva. Së pari, në adresimin e rekomandimeve të raporteve për vendin të Bashkimit Evropian. Së dyti, në përmbushjen e

obligimeve të cilat dalin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, përkatësisht përmbushja e obligimeve nga agjenda e reformave evropiane, si dhe së treti në avancimin e bazës ligjore që lidhet me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Kolegë deputetë,

Zonja ministre,

Ne e përkrahim dhe do ta keni votën e Partisë Demokratike të Kosovës.

KRYETARI: Tash nga LDK-ja, deputeti Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ndërsa sot si edhe disa herë të tjera sikur po përdoret shpesh kjo “ndërrimet substanciale”. Në të vërtetë, ky projektligj nuk ka ndërrime substanciale dhe absolutisht fare. Ky shumë më lehtë sikur të na kishte ardhur një plotësim-ndryshim i ligjit aktual. Krejt çka ka ndryshim substancial ky projektligj ka të bëjë me disa kritere për zgjedhjen e drejtorit të ri dhe janë hequr fjalët “luftimi i korrupsionit”, është fokusuar vetëm në parandalimin e korrupsionit. Diçka tjetër nuk ka. Hetimet administrative thuhet janë të ngjashme me hetimet paraprake që kanë qenë në ligjin paraprak. Madje, edhe profesionalisht kam përshtypje që ka njëfarë difiçence në Ministrinë tuaj zonja ministre.

Memorandumi shpjegues i këtij projektligji, Agjencinë Kundër Korrupsionit e fut në kuadër të institucionit të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Kështu flet. S’ka të bëjë Agjencia me sistemin e drejtësisë në Kosovë. Është krejtësisht institucion tjetër. E kemi ndërtuar për qëllime fisnike, edhe për ta luftuar korrupsionin, nëse është realizuar ai mision ndonjëherë, apo jo. Unë mendoj që gati ka qenë një agjenci, e cila nuk ka pasur efikasitet, por Agjencia s’ka të bëjë fare me sistemin e drejtësisë. Agjencia mund të referojë çështje sikur secili qytetar në Kosovë. Nëse eventualisht gjatë procesit, qoftë të deklarimit të pasurisë ose hetimeve paraprake, evidenton eventualisht ekzistencën e ndonjë veprë penale, abuzive që mund të jetë e natyrës së keqpërdorimit financiar. Tash ka ardhur si projektligj, si të tillë ne s’mund ta kundërshtojmë tash se ka hyrë në procedurë dhe gati s’ka gjë. Megjithatë, po them të provojmë nga leximi i parë në leximin e dytë si Komision ta pasurojmë nëse mundemi, eventualisht edhe më pas ta japim votën. Parimisht po e përkrahim, po vërtet po them substancë këtu s’ka fare. Kemi hyrë në këtë temë, na e keni sjellë, po e kalojmë edhe një projektligj, i cili po them edhe një herë, jo që s’ka të bëjë me substancën, por asgjë s’ka të bëjë absolutisht as me qëllimin për të cilin ka qenë, ose them është nis themelimi i këtij institucioni.

Në anën tjetër, zonja ministre e shtroi çështjen edhe te konkursi për zgjedhjen e drejtorit të ri. Zonja ministre, ju e dini që ne kemi shpallur një konkurs si Kuvend dhe është anuluar një

konkurs për të cilin unë kam qenë tërësisht kundër. A e di pse është anuluar ai konkurs? Për shkak që arsyetimet kanë qenë që nuk kanë konkurruar nga gjinia femërore. Në parim, ne mund të kemi pajtim të përgjithshëm që them angazhohemi, inkurajojmë gratë që të konkurrojnë, po s'mund të anulojmë konkurs nëse nuk konkurron dikush, sepse nëse kriteret e konkursit nuk kanë qenë diskriminuese për askënd, si mund të anulohet një konkurs? Por, ju e kishit shumicën në Komision. Ka ndodhur një veprim antiligjor, mendoj unë. Po të na referonte dikush nga kandidatët në Gjykatë Kushtetuese do të fitonte, sepse nuk kanë qenë kriteret tona diskriminuese për konkursin. Kanë qenë absolutisht afirmative.

Edhe tash, qasja jonë është që të respektohet edhe Ligji për barazi gjinore, t'i afirmojmë këto vlera, ta stimulojmë edhe gjininë femërore që të konkurrojnë për këso pozitash të rëndësishme, po s'mund të anulojmë konkurs pse s'po konkurron dikush. Këtu është problemi. Tash, nëse ne jemi vonuar deri tash në zgjedhjen e drejtorit, si rezultat i qasjes së shumicës parlamentare, ministrja thotë është mirë të shtyhet kjo, sepse me ligjin e ri ne themi që sipas rregullave të reja, drejtori i ri zgjidhet sipas këtij ligji. Nuk bën kështu, sepse ky ligj edhe dy muaj mund të mos vijë në leximin e dytë, në bazë të Rregullores së Kuvendit nga leximi i parë në leximin e dytë. Tash nëse e anulojmë edhe një herë konkursin të cilin veç e kemi mbyllur, e që ministrja po e di sa njerëz kanë konkurruar, unë si anëtar i komisionit intervistues nuk e di. Nuk e di. Nuk merrem me faqe. Unë jam institucionalist, jam anëtar i komisionit intervistues dhe dua t'i kem ato.

Në rregull, po në fakt ju e keni ditur edhe për atë listën tjetër se sa kanë konkurruar gratë, unë s'e kam parë, e kam qenë anëtar i komisionit për intervistim. Po ju e dinit, po mendoj shumica parlamentare. Prandaj, nuk guxojmë tashmë të abuzojmë më tutje. Ne duhet që kushdo që ka konkurruar të zhvillohet procedurat e rekrutimit, ta sjellim në Kuvend, e zgjedhim. Ligji mund të vlejë për konkurset e tjera. S'mund ta presim ne ligjin duke e lënë këtë institucion për të cilin ju po thirrreni që është i rëndësishëm, e ta lini pesë muaj, tre muaj a katër muaj pa drejtor, mendoj që nuk i bëjmë nder as këtij institucioni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministrja Haxhiu e ka fjalën.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Lidhur me çështjet e ngritura nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më lejoni t'i them disa çështje.

Së pari, unë edhe në fjalimin që kisha për projektligjin që mori mbështetjen e deputetëve të Kuvendit, për çka ju falënderoj, thashë në tri prej projektligjeve që i kemi gjetur nuk kemi bërë ndryshime, sepse jemi pajtuar. Ne nuk i bëjmë ndryshimet veç pse ju pastaj të thoni këtu se po paskëshit bërë ndryshime. Nuk e bëjmë nëse e mendojmë që draftet kanë qenë në rregull. Pra, ato draftet janë analizuar mirë edhe nga këshilltarët e Kabinetit tim, gjithnjë në bashkëpunim me

departamentet përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë dhe nuk kemi pasur vërejtje dhe i kemi proceduar. Kjo përmbillet këtu. Sepse e ngriti edhe deputeti Beqa, edhe znj. Deliu.

Reforma në drejtësi është jashtëzakonisht e rëndësishme për Republikën e Kosovës. Kosova apo shteti i Kosovës duhet të jetë shtet i së drejtës që aktualisht nuk është. Edhe mua s'më vjen mirë që e them këtë si ministre e Drejtësisë, por që do të angazhohem jashtëzakonisht shumë që shteti ynë të jetë shtet i së drejtës dhe ku të gjithë qytetarët të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe ku askush nuk do të jetë mbi ligjin. Ne e kemi nisur punën në reformën e thellë në sistemin e drejtësisë dhe unë besoj që koncept-dokumenti, përkatësisht vetingu në sistemin e drejtësisë, por edhe të sigurisë, është çelësi apo mekanizmi që e kemi në duar për ta reformuar sistemin e drejtësisë.

Më lejoni t'ju njoftoj se drafti i koncept-dokumentit nga Ministria e Drejtësisë është finalizuar, e kemi proceduar në Zyrën Ligjore të Kryeministrit që po e analizojnë si të tillë dhe pastaj në momentin kur Zyra e Kryeministrit, përkatësisht departamenti ligjor brenda Zyrës së Kryeministrit jep opinionin për koncept-dokumentin për vetingun, ne do ta procedojmë në Qeveri, e pastaj të bëjmë ndryshimet kushtetuese dhe ligjore për vetingun në sistemin e drejtësisë.

Po ashtu, Projektligji për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme që është po ashtu një mekanizëm shumë i rëndësishëm në luftë ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit e kemi finalizuar. Tashmë është duke u trajtuar vetëm edhe nga ekspertët. Pra, në fund fare kemi dërguar tekstet e fushës te ata ndërkombëtarë dhe vendorë dhe ata janë duke e vlerësuar si të tillë. Unë uroj që, siç tha znj. Deliu, do ta mbështetin këtë projektligj pa asnjë rezervë. Edhe Projektligjin që vjen pastaj për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme ta mbështetni pa asnjë rezervë, sepse është shumë e rëndësishme që të ndërtojmë konsensus përbrenda Kuvendit të Republikës së Kosovës, për luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Një gjë ju kisha lutur që ta adresoni në Komisionin për Legjislacion është te kriteret për drejtorin e Agjencisë, përkatësisht te mandati i tij. Ne e kemi lënë që të jetë 5+5. Unë e kam brengën që pesë vjet si drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit, në qoftë se e ka një siguresë që do ta ketë të drejtën që ta ketë edhe një mandat shtesë, përkatësisht me zgjedhje nga Kuvendi i Kosovës, po shërben si të them të jetë mirë me krejt partitë politike, në mënyrë që ta sigurojë një mandat të ardhshëm. Ju inkurajoj që ta bëni këtë ndryshim, në mënyrë që drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit ta ketë vetëm një mandat dhe atë pesëvjeçar dhe të fokusohet në punën që ka pas marrjes së mandatit.

Tjetra, unë e përmenda konkursin, sepse jam njoftuar nga Kuvendi i Kosovës. Unë e përcjell edhe faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse më intereson se çka po ndodh me

çështjet që i procedojmë ne si Ministri e Drejtësisë apo ministrinë e tjera, apo Qeveria. Prandaj, informacionin e kam marrë në faqen zyrtare, por z. Selmanaj unë s'mund për ju ta çel faqen zyrtare, se the nuk e di sa kandidatë kanë aplikuar për drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Po ashtu, nuk e përmenda anulimin e konkursit nga Komisioni për Legjislacion, sepse s'më përket mua të flas për një vendim që e ka marrë Komisioni për Legjislacion. Është e drejtë e Komisionit për Legjislacion që ta marrë një vendim të tillë. Prandaj, interes yni është që drejtori i Agjencisë të zgjidhet, mirëpo në qoftë se Komisioni vlerëson që duhet të përsëritet konkursi, sepse duhet të aplikojnë gra, unë pajtohem, s'kam çka të kundërshtoj në këtë drejtim. Unë jam njoftuar nga vetë Kuvendi i Kosovës po ashtu me njoftim zyrtar që është anuluar konkursi dhe është hapur konkursi tjetër.

Edhe një herë ju inkurajoj që për vërejtjet që keni për projektligjin t'i adresoni, në mënyrë që ta kemi një ligj sa më të mirë dhe që të jetë i zbatueshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Një replikë mbi këtë që e tha ministrja, deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Ju faleminderit zoti Kryetar i Kuvendit!

Vetëm të them diçka sa i përket konkursit të përmendur nga z. Selmanaj për kryeshef të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Në fakt, derisa po e dëgjoja ministren që foli për agjendë të qartë në fushën e sundimit të ligjit, kjo pak nuk po më korrespondon me politikën që Qeveria i ka në raport me përzgjedhjen e pozitave kaq të rëndësishme siç është pozita e kryeshefit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Si anëtar të komisionit, dua të saktësoj se konkursi është hapur për këtë pozitë në muajin korrik dhe ta keni parasysh që ne tash jemi pothuajse në fund të vitit dhe për një kohë kaq të gjatë, kur Qeveria nuk arrin që për një pozitë kaq të rëndësishme të ketë një emër kredibil i cili siguron që me të vërtetë fusha e sundimit të ligjit të jetë më efikase, kjo flet për politikën që Qeveria i ka në raport me pozitën kaq të rëndësishme të institucioneve të pavarura. Dua të plotësoj zotën Selmanaj, janë 21 kandidatë të cilët kanë konkurruar në konkursin e fundit, të cilëve u është shkelur e drejta e tyre në konkurrim.

Ka plotësisht të drejtë z. Selmanaj çfarë tha sot. Qeveria duhet t'i inkurajojë që gratë t'u nënshtrihen këtyre proceseve të konkurrimit dhe të jenë të barabarta në konkurset të cilat hapen nga institucionet tona. D.m.th. në vend që t'i inkurajojë gratë që të jenë pjesë e këtyre proceseve të rëndësishme dhe të bëhen pjesë e konkurseve si këto, mazhoranca zgjodhi që t'ua minojë, t'ua humbë të drejtën 21 aplikantëve të cilët kanë aplikuar në konkursin e parë dhe janë privuar nga e drejta për të qenë pjesë e këtij institucioni kaq të rëndësishëm. Unë e kam parasysh agjendën gjinore. Unë jam shumë e vetëdijshme sesa e rëndësishme është t'i motivojmë gratë me 50-përqindëshin që të jenë pjesë e bordeve të institucioneve të pavarura, zonja ministre. Por, keni rol

dhe përgjegjësi që ta bëni këtë me politikat e juaja qeveritare, por nuk duhet që krahas kësaj t'ua minoni të drejtën 21 vetave dhe të lini...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro znj. Deliu ta përfundojë fjalën e saj edhe disa sekonda...

BLERTA DELIU-KODRA: Dhe ta lini një institucion të tillë vakant. E tha z. Selmanaj dhe po e ripërsëris, prej korrikut ka qaq muaj që ky institucion është pa kryeshef. Tash nëse kjo bëhet me ligjin e ri, ne rrezikojmë që brenda këtij viti një institucion qaq të rëndësishëm ta lëmë pa kryeshef dhe pa kredibilitet në kuptimin e fushës qaq të rëndësishme që e ka ky institucion.

KRYETARI: Zoti Selmanaj e ka fjalën po ashtu për një replikë.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Në fakt unë kur thashë që në memorandumun shpjegues nga ka ardhur prej Ministrisë së Drejtësisë, kur e lexon paragrafin i referohet Agjencisë si organ i sistemit të drejtësisë, e mora si një shkarje të atyre njerëzve që e kanë shkruar. Por, tash kur ministrja del flet për sistemin e drejtësisë dhe s'është temë fare sistemi i drejtësisë në Kosovë... Ne po flasim për Projektligjin për Agjencinë, i cili nuk është organ i sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe nuk ka të bëjë fare kjo me çështjet e tjera. Pajtohem tërësisht dhe do ta mbështetim edhe për çështjen e vetingut nëse është një dokument përmbajtësor ose substancial, po pajtohem çfarëdo ndryshimi që do ta sjellë në kontekstin e reformës së sistemit të drejtësisë, por s'është temë kjo. Nëse i përziejme këto, i ngatërrojmë, kam problem serioz, a është e mundur që qasja e Ministrisë së Drejtësisë të jetë kjo? Kur bëjmë gabime të tilla elementare, bazike të institucioneve, atëherë çka mund të presim ne për çështje të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Një replikë, me siguri me fusnotën e sqarimit, Doarsa Kica-Xhelili e ka fjalën.

DOARSA KICA-XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Atëherë, shumë shkurtimisht meqenëse unë jam gjithashtu anëtare e Komisionit për Legjislacion, ku merr pjesë gjithashtu edhe zoti Selmanaj, edhe zonja Deliu.

Pak po më çudit ky ndryshim qaq drastik i qëndrimit rreth asaj se sa është e rëndësishme të promovohet barazia gjinore në nivel institucional. Dhe, vlerësoj se do të ishte mirë që në raste si këto, ndoshta të kërkojmë që të dëgjohen ato mbledhje publike dhe të vështrojmë realisht se çfarë është thënë nga deputetët përkatës, sepse kur po vijnë këtu po ndryshojnë qëndrimet mjaft shumë.

Unë dua t'u rikthehem dy çështjeve elementare. E para, këtu po thuhet që 20 aplikantët e radhës së parë po pengohen tani që të jenë pjesë e konkursit. Kjo është plotësisht e pavërtetë. Në asnjë format atyre nuk u është pamundësuar riaplikimi. Përkundrazi, nuk ka ardhur si propozim nga Qeveria çështja e barazisë gjinore, ka ardhur si propozim i njërit anëtar të komisionit, i cili ka qenë edhe anëtar i grupit punues.

Dhe më pas, pas një diskutimi mjaft të gjatë lidhur me këtë propozim, jemi dakorduar që së pari të gjithë aplikantëve të radhës së parë t'u mundësohet riaplikimi, dhe në fakt kemi shkuar një hap tutje me propozimin që secili të thirret në telefon, secilit t'i dërgohet në format elektronik edhe një herë njoftimi që të gjithë mund të riaplikojnë dhe thirren që të riaplikojnë në faktin që kjo po bëhet për promovim të barazisë gjinore.

Dhe, në fakt, promovimi i barazisë gjinore në këtë nivel është edhe atribut që i është vënë gurthemeli me Ligjin për barazi gjinore, kur ndër të tjera parasheh edhe masa të veçanta kur bëhet promovimi i barazisë gjinore edhe në nivel institucional.

Pra, në rregull, flasim për aspektin procedural të anulimit të konkursit, mirëpo ne e kemi sqaruar saktësisht bazën ligjore mbi të cilën po e bëjmë anulimin e konkursit. Ende pa e anuluar kemi ndërmarrë masa të veçanta që aplikantëve t'u minimizohet dëmi, pra që ata të mos...

KRYETARI: 60 sekonda Blerta Deliut për një kundër-replikë.

BLERTA DELIU-KODRA: Atëherë, nuk është e vërtetë ajo që sapo u tha. Në fakt, ne e kemi saktësuar edhe në komision rëndësinë e agjendës së barazisë gjinore, por dua t'jua kujtoj edhe gjë që e kemi thënë edhe në komision.

Kjo Qeveri ka zgjedhur që pikërisht kryeshefe të institucioneve të rëndësishme si KQZ-ja, siç ka qenë zonja Daka, ta largojë nga ky pozicion kaq i rëndësishëm, dhe sot më flasim për standarde të barazisë gjinore, të cilat Qeveria e ka për obligim që t'i inkurajojë aplikantët që të bëhen pjesë e këtyre konkurseve, por të mos ndodhin këso lloj shkarjesh të cilat ju i bëni vazhdimisht. Do të thotë, thirreni atëherë ku u konvenon, por jo nuk janë parime të cilat zbatohen prej Qeverisë Kurti.

KRYETARI: Edhe zoti Selmanaj i ka 60 sekonda.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Megjithëse kam shumë respekt për zonjën Kica, duhet ta demantoj. Unë gjithçka çka thashë këtu është në procesverbale të komisionit dhe i kam thënë. Madje filluan të më portretizojnë sikur unë jam kundër barazisë gjinore. Absolutisht, e pavërtetë.

Kanë thënë që jemi duke e shkelur ligjin. Pavarësisht që kemi qëllime fisnike dhe afirmative, dhe çfarë tha zonja Kica, këtë e konfirmoj. Tha kështu: “Kemi bërë përpjekje për ta minimizuar dëmin e shkaktuar”. Domethënë dëmi është shkaktuar. Tashti përpjekja ka qenë se si të minimizohet ai dëm.

Prandaj, unë po them, duhet të jemi të kujdesshëm si Komision për Legjislacion. Ne duhet të jemi ata që e mbrojmë ligjin, jo që e shkelim ligjin, sado që qëllimet prapa mund të jenë të mira. Por, ligjet ne i kemi bërë të mira, të tilla çfarë janë, kështu janë.

Kriteret e konkursit të mos jenë diskriminues, dhe aq mjafton, diçka tjetër s’mund të bëjmë. Unë angazhohem maksimalisht që t’i respektojmë ligjet që ne i miratojmë. Nëse ne i shkelim ato për qëllime edhe fisnike, i bie që ne edhe shumë punë të këqija...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Për një sqarim përfundimtar të shkurtër, 60 sekonda zonja Kica.

DOARSA KICA-XHELILI: Sa i përket krahasimit me rastin e KQZ-së është krahasim plotësisht irelevant. Ne nuk bëjmë thirrje për barazi gjinore në dëm të meritokracisë.

Sa u përket çështjeve që u thanë nga zoti Selmanaj, absolutisht nuk e kemi anashkaluar mundësinë që anulimi i konkursit nuk bëhet mbi ndonjë dispozitë shprehimore. Këtë e kemi thënë të gjithë anëtarët, të cilët edhe e kemi votuar. Por, ka qenë fryma e Ligjit për barazi gjinore, në emër të masave të veçanta që ne e kemi bërë këtë thirrje.

Ne në fakt e kemi pranuar që nuk ka dispozitë shprehimore. Do të thotë, këtë e ke edhe në procesverbalin të cilit ju po i referoheni. Ka qenë plotësisht temë, diskurs dhe ligj tjetër kur ne i jemi referuar për anulim të këtij konkursi. Faleminderit!

KRYETARI: Pse e do fjalën zoti Rrustemi? Për këtë çështje? I keni minutat e një replike dhe mund t’i shfrytëzoni nëse doni në lidhje me atë që e ka thënë ministrja.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Përkundër që sot e kemi në rend dite shqyrtimin në dëgjim të parë të Projektligjit për parandalimin e korrupsionit, e kuptoj që ndërlidhet me Agjencinë Kundër Korrupsionit, po më duhet t’i jap disa sqarime, por jo domosdo si replikë.

Në radhë të parë, ripërsëritja ose rishpallja e konkursit për drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit është bazuar në tri arsye, ose në tri argumente. Natyrisht ka buruar nga fryma e Ligjit për barazi gjinore si propozim i një anëtari të Komisionit për Legjislacion, me të cilin jemi

pajtuar me argumente paçka që kemi pasur dallime në mesin anëtarëve për procedurën, por ka qenë edhe dy argumente të tjera.

Grupi punues, i themeluar nga komisioni, edhe për shkak të angazhimeve thuajse e ka tejkaluar afatin e procedurës administrative, meqë në ligjin bazik nuk përcaktohet një afat i brendshëm të hetimi i dokumenteve, ka qenë arsye shtesë, dhe ne do të shkonim në rishpallje brenda dy ditëve, gjithsesi. Duhet të jemi korrektë si anëtarë të komisionit.

E treta, kemi filluar bashkëpunimin, ose memorandumimin me Ambasadën britanike, është nënshkruar pikërisht në ato ditë, dhe për të krijuar kushte dhe përgatitje të mira për një proces, për një monitorim, e kanë kompletuar këtë mozaikun e argumenteve.

Sa për sqarim, Qeveria nuk e propozon drejtorin ose kryeshefin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, është konkurs i Kuvendit të Kosovës, i hapur, aplikojnë dhe përzgjidhen.

Dhe duhet ta them, nuk ka asnjë cenim. Madje, secili prej atyre që ka aplikuar herën e parë, pothuajse ka riaplikuar edhe herën e dytë.

Dhe e fundit, të mërkurën e kemi mbledhjen e komisionit. Debatin që s'e kemi bërë ende në komision, të mos e bëjmë paraprakisht në seancë. E diskutojmë të mërkurën. E kemi themeluar grupin punues për herën e dytë, anëtarët e opozitës janë aty dhe le të fillojmë pas pushimit ndërmjet dy sesioneve t'i trajtojmë dokumentacionet dhe të rekomandojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: 60 sekonda Driton Selmanajt dhe po hyjmë në votim.

DRITON SELMANAJ: Unë po sugjeroj që vërtet ta mbyllem këtë temë, por vetëm dua ta them edhe këtë: Është shumë e vërtetë çka tha zoti Rrustemi, që grupi punues është vonuar në trajtimin e biografive të CV-e të kandidatëve. Po a e dini se kush e ka udhëhequr atë grup punues? Alban Hyseni i Vetëvendosjes. Ai nuk na thërriste neve si anëtarë të grupit punues që t'i trajtojmë ato. Ai e ka lënë me qëllim që të vijmë deri në fund që të kalojmë afati ligjor dhe ne ta rishpallim konkursin. Kjo është e vërteta.

Prandaj, është mirë të mbyllet kjo, sepse e kemi rishpallur konkursin, pavarësisht që kemi bërë shkelje ligjore. Po ju them, unë kam qenë kundër, por është bërë ajo, dëmi është bërë. Pajtohem që duhet të minimizohet dëmi i shkaktuar dhe tash të ecim tutje. Por, kërkesa e ministres ishte që ta shtyjmë edhe këtë konkurs. Me ligj të ri të bëjmë... ose së paku ashtu të kuptova. Nëse të kam kuptuar ndryshe, atëherë të kërkoj ndjesë! Tërhiqem atëherë, nëse të kam kuptuar ndryshe.

Unë mendoj që duhet ta zgjidhim sa më shpejt që është e mundur, në mënyrë që atë institucion ta bëjmë me drejtor.

KRYETARI: Fjalën e ka vetëm ministrja dhe po hyjmë në votim, Adnan!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Veç ta sqaroj këtë pjesën që e përmendi zoti Selmanaj. Unë nuk thashë që shtyjeni procedurën, apo procedurat e zgjedhjes së drejtorit. Thashë, le ta vlerësojë Komisioni për Legjislacion për faktin se projektligji parasheh që drejtori të zgjidhet sipas këtij ligji.

Nëse nuk pajtoheni me këtë, jeni anëtarë të komisionit, bëjeni amendamentin, ndryshojeni këtë dispozitë. Faleminderit!

KRYETARI: Sa deputetë i kemi të pranishëm, ju lutem?! 71 deputetë qenkan në sallë. Atëherë hyjmë në votim të ligjit.

Të nderuar deputetë,

Ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni lidhur me Projektligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, konstatoj që 71 deputetë, pra të gjithë të pranishmi, kanë votuar për këtë projektligj, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Kështu që konstatoj se Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin bashkë me rekomandimet.

Tash dalim në pikën e fundit të rendit të ditës, e cila shkon shpejt ma merr mendja:

6. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 8 anëtarë nga komuniteti shqiptar dhe 1 anëtar nga komuniteti serb në Bordin e RTK-së

Të nderuar deputetë,

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator, ka kërkuar nga grupet parlamentare që Kuvendit t'ia propozojnë deputetët për kryetar të këtij komisioni ad hoc, zëvendëskryetarët dhe anëtarët e tij.

E ftoj me këtë rast Grupin Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje që ta propozojë zëvendëskryetarin e parë që i takon në këtë komision, si dhe katër anëtarë të këtij komisioni. Zonja Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Po e propozoj listën 5 përfaqësuesve nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje për këtë komision.

Në komision pozitën e nënkryetares: Mimoza Kusari-Lila, pastaj anëtarë: Doarsa Kica-Xhelili, Armend Muja, Saranda Bogujevci dhe Ardian Gola.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i PDK-së i ka 2 anëtarë të komisionit. Nëse i keni të gatshëm emrat... Mund të konsultoheni në ndërkohë me kryetarin e Grupit Parlamentar, sepse jemi marrë vesh me të në Kryesi.

Grupi Parlamentar i LDK-së e udhëheq këtë komision. Pra, i takon kryetari i komisionit. Zonja Hykmete Bajrami e bën këtë propozim. Urdhëroni e keni fjalën!

HYKMETET BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës për kryetar të komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 8 kandidatëve nga komuniteti shqiptar dhe 1 kandidati nga komuniteti serb për Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës e propozon deputetin Armend Zemaj.

KRYETARI: Deputeti Armend Zemaj e udhëheq këtë komision. Nuk e keni bërë llogaritjen mirë?! A i takon vetëm kryetari LDK-së? Vetëm kryetari LDK-së. Mirë!

Kalojmë te Lista serbe. Ata e kanë bërë propozimin më herët, para se të vijmë në seancë, është Igor Simiq, që është propozuar si anëtar.

Grupi Parlamentar i AAK-së nuk është askush në sallë për momentin që ta bëjë propozimin. Mund ta plotësojmë në ndërkohë. Nga Grupi Parlamentar Multientik, fjalën e ka kryetari Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Ne si grup parlamentar e kemi propozuar deputeten Duda Balje.

KRYETARI: Duda Balje propozohet nga ky grup. Ndërkohë Partia Demokratike e Kosovës i ka 2 anëtarë të këtij komisioni. Deputetja Ganimete Musliu i prezanton ata.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës janë Mërgim Lushtaku dhe Blerta Deliu-Kodra.

KRYETARI: Mërgim Lushtaku dhe Blerta Deliu-Kodra. Ta votojmë në këtë përbërje. Me mungesë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës...

Kjo na paraqet problem, sepse duhet ta votojmë me një procedurë tjetër vetëm anëtarin që po mbetet i AAK-së. T'i marrim nja dy minuta kohë derisa ta kontaktojmë Grupin Parlamentar të AAK-së, sepse ma merr mendja që kjo është më shumë çështje teknike për të cilën ata kanë vendosur, ma merr mendja më herët, por në mungesë të tyre nuk po mund të ta kemi anëtarin e AAK-së.

Ju lutem Sekretaria nëse mund ta kontaktoni kryetarin e këtij grupi, Besnik Tahirin!

(Ndërprerje e incizimit)

Atëherë, e morëm edhe konfirmimin nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Albana Bytyqi nga ky grup parlamentar propozohet që të jetë anëtare e këtij komisioni.

Në ndërkohë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje më lajmërojnë se duan ta zëvendësojnë një anëtar me një tjetër. Zonja Mimoza Kusari, kryetarja e grupit na njofton për këtë ndryshim. Urdhëroni, e keni fjalën!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Desha vetëm të bëj lëvizje për nënkryetar të komisionit, deputeti Armend Muja në vendin tim, ndërsa shtesë në komision, deputeti Fitim Uka.

KRYETARI: Atëherë, si zëvendëskryetar i parë i këtij komisioni bëhet si propozim nga Vetëvendosja që të jetë deputeti Armend Muja, kurse Fitim Uka të jetë anëtar i cili e zëvendëson Valon Ramadanin, a po? Mimosë? Mirë!

Lexoji edhe një herë për shkaqe zyrtare.

MIMOZA KUSARI-LILA: Po! Armend Muja nënkryetar, Doarsa Kica-Xhelili, Saranda Bogujevci, Ardian Gola dhe Fitim Uka, anëtarë.

KRYETARI: Këto janë propozimet e Lëvizjes Vetëvendosje dhe me të gjitha propozimet tjera të cilat i dëgjuat prej grupeve parlamentare hyjmë në procedurë të votimit të përbërjes së këtij komisioni ad hoc.

Në sallë janë të pranishëm 68 deputetë. Ju lus që me ngritje dore të votojmë për përbërjen e këtij komisioni ad hoc.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatohet që të gjithë deputetët e pranishëm kanë marrë pjesë në votim. Pra, me 68 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miraton në këtë përbërje Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës që të veprojnë në përputhje me Ligjin nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Në këtë moment edhe i mbylлим punimet kësaj seance plenare. Mirupafshim në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*